



Funded by  
the European Union



# METODOLOGJIA E MATJES PERIODIKE TË PERCEPTIMIT PUBLIK DHE PËRVOJAVE MBI KORRUPSIONIN

---

2024



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



A.L.T.R.I



"Metodologjia e Matjes Periodike të Perceptimit Publik dhe Përvojave mbi Korrupsionin" u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!", financuar nga Bashkimi Evropian dhe që zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në partneritet me Qendrën ALTRI dhe Friends of Europe.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Qendrës A.L.T.R.I dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**Qendra ALTRI**

**Email: [qendra.altri@gmail.com](mailto:qendra.altri@gmail.com)**

# TABELA E PERMBAJTJES

|                                                                       |    |
|-----------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje                                                                 | 5  |
| 1. Qëllimi dhe objektivat e metodologjisë                             | 6  |
| 2. Matja e korrupsionit                                               | 8  |
| 2.1. Mjetet e matjes së korrupsionit në nivel ndërkombëtar            | 8  |
| 2.2. Matja e perceptimit të nivelit të korrupsionit në nivel kombëtar | 13 |
| 3. Metodatat për matjen e korrupsionit                                | 14 |
| 4. Të dhënat që synohen të mblidhen                                   | 16 |
| 5. Mënyrat e mbledhjes së të dhënave                                  | 18 |
| 6. Fokus grupet                                                       | 20 |
| 7. Anketat/pyetësorët për korrupsionin                                | 22 |
| 7.1 Kategoritë kryesore të anketave për korrupsionin                  | 23 |
| 7.2 Hapat për realizimin e anketës/pyetësorit                         | 23 |
| 8. Metodatat e kampionimit                                            | 25 |
| 9. Dizenjimi i Pyetësorit                                             | 26 |
| 10. Pilotimi i pyetësorit                                             | 28 |
| 11. Parimet e etikës dhe profesionalizmit gjatë realizimit të anketës | 30 |
| 12. Analiza e të dhënave                                              | 32 |
| 13. Korniza kohore dhe buxhetimi                                      | 34 |
| 14. Raportimi dhe shpërndarja                                         | 35 |
| 15. Vlefshmëria dhe besueshmëria                                      | 37 |
| 16. Konkluzionet dhe Rekomandimet                                     | 39 |
| Shtojca nr.1 Model pyetësori perceptimi                               | 41 |
| Shtojca nr.2. Model pyetësori përvojë                                 | 44 |
| Shtojca nr.3. Model pyetësori për bizneset                            | 47 |

# SHKURTIME

|      |                                                  |
|------|--------------------------------------------------|
| BGK  | Barometri Global i Korrupsionit                  |
| DPAK | Drejtori e Përgjithshme e Antikorrupsionit       |
| FMN  | Fondi Monetar Ndërkombëtar                       |
| IABH | Indeksi dhe Anketa e Buxhetit të Hapur           |
| IIG  | Indeksi i Integritetit Global                    |
| IIP  | Indeksi i Integritetit Publik                    |
| IPK  | Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit            |
| KKKK | Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit        |
| MRR  | Matrica e Rrezikut/Riskut të Ryshfetit           |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| OKB  | Organizata e Kombeve të Bashkuara                |
| OSHC | Organizatat e Shoqërisë Civile                   |



Korrupsioni është një fenomen negativ që përbën problematikë të konsiderueshme sot veçanërisht në shoqëritë në tranzicion dhe në zhvillim. Korrupsioni cenon shtetin e së drejtës dhe qeverisjen e mirë në dobi të qytetarëve dhe konsiderohet edhe një pengesë kryesore në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Përveç dëmit që i sjell shtetit dhe institucioneve të tij, korrupsioni si fenomen ndikon edhe tek qytetarët dhe tek perceptimi i tyre për qeverisjen dhe institucionet shtetërore. Për një angazhim efektiv të qytetarëve, autoritetet publike duhet t'i konsiderojnë qytetarët si përfitues të shërbimeve publike që ofrojnë reagimet dhe opinionet e tyre për të përshtatur politikat publike dhe reformat. Qytetarët konsiderohen partnerë që kontribuojnë në qeverisjen e vendit dhe ndihmojnë në zgjidhje për problemet e përbashkëta që has shoqëria në lidhje me korrupsionin. Ndaj merr rëndësi matja e perceptimit qytetar në mënyrë të vazhdueshme për të kuptuar shqetësimet dhe problematikat në fusha të caktuara, me qëllim marrjen e masave përmes veprimeve aktive dhe ndërhyrjeve të përshtatshme për të përmirësuar situatën si dhe efektivitetin e masave dhe mekanizmave kundër korrupsionit.

Deri më sot, institucionet publik janë mbështetur në të dhënat e raporteve të organizatave ndërkombëtare pa pasur një metodologji të qartë për matjen sistematike/të vazhdueshme të perceptimit të publikut për korrupsionin, përcaktimin e objektivave, përcaktimin e të dhënave që do të mbledhen, popullatën e synuar, metodat e përdorura, formatet që do të përdoren, instrumentet e kërkimit, mbledhja dhe analiza e të dhënave, hartimi i gjetjeve dhe rekomandimeve, etj. Nevoja për të hartuar një dokument të tillë është identifikuar nga ministria përgjegjëse për antikorrupsionin në vlerësimin e nevojave për asistencë teknike në kuadër të luftës kundër korrupsionit.



## 1. Qëllimi dhe objektivat e metodologjisë

Në kuadër të përpjekjeve për të forcuar luftën kundër korrupsionit përmes politikave dhe institucioneve efikase si dhe mekanizmave që gëzojnë besimin e publikut, qëllimi i metodologjisë është hartimi i metodave të matjes në mënyrë sistematike të perceptimit publik mbi nivelin e korrupsionit me objektiv vlerësimin e efikasitetit të politikave dhe reformave të ndërmarra nga këndvështrimi i pritshmërisë së publikut.

Duke mbajtur në konsideratë kompetencat e ministrit përgjegjës për antikorrupsionin objektivat e synuara nga metodologjia janë:

- 1 Udhëzimi i metodave dhe mjeteve për mbledhjen e të dhënave mbi perceptimin dhe përvojën e individëve mbi korrupsionin në vend si dhe mbi efektivitetin e politikave kombëtare, masave të ndërmarra dhe institucioneve dhe mekanizmave kundër korrupsionit;
- 2 Vlerësimi i perceptimit të qytetarëve mbi nivelin e korrupsionit në vend dhe efektivitetin e politikave kombëtare, masave dhe mekanizmave kundër korrupsionit.
- 3 Identifikimi i nevojave për përmirësimin e politikave, masave, dhe mekanizmave kundër korrupsionit, në varësi të konkluzioneve të identifikuara nga matja e perceptimit publik dhe përvojave.

Duke marrë në konsideratë që Metodologjia e matjes periodike të perceptimit publik dhe përvojave mbi korrupsionin (në vijim Metodologjia) është hartuar që t'i shërbejë ministrit përgjegjës për antikorrupsionin për të matur periodikisht dhe në nivel kombëtar perceptimin publik dhe përvojat për korrupsionin dhe efektivitetin e mekanizmave kundër korrupsionit, është e rëndësishme që të ndalemi tek kompetencat e këtij institucioni në luftën kundër korrupsionit. Kështu, autoriteti më i lartë në nivel ekzekutiv që drejton dhe udhëheq politikat shtetërore kundër korrupsionit është Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKKK) që ushtrohet nga ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Me vendimin nr. 29, datë 17.1.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin" u përcaktua se ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit.

<sup>1</sup>Vendimin nr 29, datë 17.1.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin" <https://qbz.gov.al/share/Z7CYOIDSgekKaYN7P-RMw>



Sipas pikës 4 të këtij vendimi "Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj, me akte të Këshillit të Ministrave dhe nga Kryeministri."

Një ndër përgjegjësitë e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është drejtimi dhe bashkërendimi i punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Me vendimin nr. 618, datë 20.10. 2021 të Këshillit të Ministrave u krijua Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit nën drejtimin e ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Në vijim me krijimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ky vendim u shfuqizua me vendimin nr. 436, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

Me vendimin 436, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave, u krijua e para Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, si një person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Misioni i DPAK-së është të sigurojë parandalimin e goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore/entet publike/shoqëritë tregtare me kapital shtetëror.

DPAK-ja ka kompetenca e përgjegjësi funksionale për:

- a)** koordinimin dhe përcaktimin e instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit;
- b)** zhvillimin e projekteve e të programeve në fushën kundër korrupsionit;
- c)** rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e politikave të fushës kundër korrupsionit;
- ç)** kryerjen e hetimit administrativ në kuadër të denoncimeve ose ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve ku DPAK-ja shtrin aktivitetin, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi;
- d)** rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e politikave të fushës kundër korrupsionit;

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit bashkëpunon ngushtë me Koordinatorët Antikorrupsion, që mbetet struktura teknike që mbledhin informacion për veprimtaritë korruptive, praktikat abuzive apo arbitrare, nga burime të ndryshme dhe kryejnë hetime administrative edhe përmes bashkëpunimit me strukturën përgjegjëse për antikorrupsionin në DPAK si dhe strukturat e brendshme të institucionit, entit publik, apo shoqërisë tregtare me kapital shtetëror për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit.



## 2. Matja e korrupsionit

### 2.1. Mjetet e matjes së korrupsionit në nivel ndërkombëtar

Prej vitesh tashmë ekzistojnë një sërë mjetesh të matjes së nivelit të korrupsionit apo të vlerësimit të qeverisjes të një vendi. Më poshtë paraqiten vetëm disa prej tyre, të cilët zbatohen edhe në Shqipëri dhe synojnë mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore të perceptimit publik të korrupsionit, të mirëqeverisjes, të efikasitetit të politikave shtetërore, kuadrit ligjor dhe institucional<sup>2</sup>.

***Indeksi i Bazelit kundër Pastrimit të Parave, i zhvilluar çdo vit nga Instituti i Bazelit***<sup>3</sup> për Qeverisje mat riskun për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në mbarë botën. Ai bazohet në një metodologji të përbërë nga 18 tregues të kategorizuar në pesë fusha kryesore që konsiderohen se kontribuojnë në rritjen e riskut për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit (cilësia e kornizës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, korrupsioni, transparenca financiare dhe standardet, transparenca dhe llogaridhënia, të drejtat politike dhe sundimi i ligjit). Gjithashtu, Indeksi i Bazelit mat se si vendet i përgjigjen këtyre risqeve, vlerëson progresin ndër vite dhe mundëson një krahasim të riskut midis vendeve të ndryshme. Secila nga fushat është ndërtuar nga 18 burime të disponueshme publikisht dhe nga vlerësimi i akademikëve, ekspertëve të sektorit financiar dhe ekspertëve të fushës.

***Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (IPK) i zhvilluar nga Transparency International***<sup>4</sup>, është një indeks i përbërë që përdor burime të ndryshme të dhënash nga institucione të pavarura dhe të specializuara në analizën e qeverisjes dhe klimës së biznesit. Burimet e informacionit të përdorura për IPK bazohen në të dhënat e mbledhura në 24 muaj. IPK synon të masë perceptimin mbi nivelin e korrupsionit në sektorin publik të një vendi, bazuar në sondazhet dhe vlerësimet e ekspertëve në këtë fushë (çdo vit). Që prej 2012 dhe bazuar në metodologjinë e përditësuar, çdo vendi i jepet një renditje duke reflektuar pozicionin e këtij vendi në raport me vendet e tjera të përfshira në vlerësim. Ky indeks jep një informacion mbi nivelin e perceptimit të korrupsionit në sektorin publik, në krahasim me vendet e tjera të vlerësuara. IPK është një indeks global/ndërkombëtar që përfshin një numër të madh vendesh. Megjithatë, IPK nuk bën një matje konkrete të nivelit të korrupsionit në vend dhe as nuk vlerëson kornizën institucionale. Vlerësimi i perceptimit të publikut për korrupsionin nuk reflekton domosdoshmërisht nivelin real të korrupsionit në një vend. Gjithashtu, IPK nuk bën dallim ndërmjet llojeve të ndryshme të korrupsionit si dhe nuk mund të përdoret për të vlerësuar efektet e një reforme specifike pasi perceptimi ndryshon me hapa të ngadalta<sup>5</sup>.

<sup>2</sup>Për më shumë shih: How-to guide for corruption assessment tools (3rd edition), 2022, Transparency International:

<https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/How-to-guide-for-corruption-assessment-tools-2022.pdf>

<sup>3</sup>Për më shumë shih: <https://index.baselgovernance.org/methodology>

<sup>4</sup>Për më shumë shih: <https://www.transparency.org/en/cpi/2022>

<sup>5</sup>How-to guide for corruption assessment tools (3rd edition), 2022, Transparency International:

<https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/How-to-guide-for-corruption-assessment-tools-2022.pdf>



**Barometri Global i Korrupsionit (BGK)/ Global Risk Profile<sup>6</sup>**, mat nivelin e korrupsionit në 196 shtete (përfshirë Shqipërinë) duke i renditur sipas nivelit të riskut (nga 0 deri në 100). Indeksi përdor katër tregues për të matur nivelin e korrupsionit: ratifikimin e konventave kryesore, nivelin e korrupsionit të perceptuar, përvojat e raportuara të korrupsionit nga individët dhe sektori privat dhe një përzgjedhje e karakteristikave/specifikave të një shteti të lidhura ngushtë me korrupsionin. Lidhur me mekanizmat parandalues maten 4 indikatorë: zëri i qytetarëve dhe transparencë, efikasiteti i qeverisjes, kuadri ligjor dhe ai politik. BGK mbështetet në shumë entitete për ofrimin e të dhënave të papërpunuara, si OKB-ja, OECD, Banka Botërore, Transparency International, Instituti i Bazelit për Qeverisje, etj. Megjithatë, në indeks përfshihen shumë koncepte, si p.sh. demokracia dhe kuadri ligjor si dhe një gamë e gjerë të dhënash të ndryshme, të cilat nuk janë domosdoshmërisht relevante për matjen e korrupsionit. Për më tepër, të dhënat e plota dhe metodologjia e përdorur nuk janë të disponueshme lirisht për publikun.

**Indeksi i Integritetit Publik (IIP)/ERCAS and Hertie School of Governance<sup>7</sup>**, i cili zhvillohet çdo 2 vjet në 114 shtete përfshirë Shqipërinë. IIP është një indeks i përbërë që synon të ofrojë një mjet matës të kapacitetit të një vendi për të kontrolluar korrupsionin dhe për të siguruar integritetin. Treguesi i vetëm i përbërë bazohet në një vlerësim të gjashtë komponentëve: transparencë buxhetore, transparencë administrative, shërbimet online, pavarësia gjyqësore, shtetësia dhe liria e shtypit. Indeksi bazohet në një sërë burimesh të dhënash të mbledhura nga organizata të tjera dhe vlerësohet si një indeks që bazohet në faktorë të testuar empirikisht në kontekste të ndryshme të qeverisjes dhe është i orientuar drejt politikave pasi është ndërtuar nga gjashtë shtylla vepruese që janë të lidhura me politikat kundër korrupsionit, ndaj mund të shërbejë si mjet për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit.

**Indeksi i Sundimit të Ligjit/World Justice Project<sup>8</sup>** që kryhet çdo vit në nivel global dhe bazohet në të dhëna sasiore të mbledhura nga një sondazh i gjerë publik dhe pyetësorë të detajuar të plotësuar nga akademikë, praktikantë, ekspertë, përfaqësues të OSHC-ve, etj. Ky indeks vlerëson nivelin e sundimit të ligjit në një vend në këndvështrimin dhe perceptimin e individëve të zakonshëm që preken drejtpërdrejt nga moszbatimi i ligjit dhe në këndvështrimin e ekspertëve për tema të tilla si, efikasiteti i gjykatave, niveli i zbatimit të ligjit, besueshmëria e mekanizmave të llogaridhënies, etj. Ky indeks ofron një pamje të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë dimensioneve të shtetit të së drejtës dhe shqyrton tre forma të korrupsionit: mitmarrjen, ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike dhe shpërdorimin e detyrës dhe fondeve publike. Ndërkohë që ky indeks është nga të parët që ofron një panoramë të nivelit të sundimit të ligjit në një vend, ai nuk identifikon shkaqet që çojnë në një rezultat të caktuar dhe nuk ofron zgjidhjet për të adresuar problematikat.

---

<sup>6</sup>Për më shumë shih: <https://risk-indexes.com/global-corruption-index/>

<sup>7</sup>Për më shumë shih: <https://corruptionrisk.org/integrity/>

<sup>8</sup>Për më shumë shih: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/downloads/Index-2022>

**Matrica e Rrezikut/Riskut të Ryshfetit (MRR)/TRACE International<sup>9</sup>**, i cili zhvillohet çdo vit në 194 shtete, përfshirë Shqipërinë. MRR mat riskun për mitmarrje nga sektori privat/bizneset dhe niveli i rrezikut për çdo shtet përcaktohet nga katër fusha kryesore: ndërveprimet e biznesit me Qeverinë, parashikimi dhe zbatimi i masave parandaluese kundër mitmarrjes, transparenca dhe kapacitetet mbikëqyrëse të OSHC-ve. MRR trajton shqetësimet e shoqërive tregtare që zhvillojnë veprimtarinë tregtare në nivel ndërkombëtar dhe ofron një vlerësim prej bizneseve se sa janë mundësitë në një vend që një zyrtar publik të kërkojë ryshfet si dhe qëndrimet e shoqërisë ndaj ryshfetit. Gjithashtu, të dhënat shërbejnë për të krahasuar progresin dhe tendencat midis vendeve ndër vite sipas 4 fushave. MRR bazohet në një sërë burimesh të dhënash publike të mbledhura nga organizata të tjera.

**Indeksi i Integritetit Global (IIG)/Global Integrity<sup>10</sup>**, i cili zhvillohet çdo vit në 200 shtete, përfshirë Shqipërinë. Indeksi ofron një vlerësim të cilësisë së gjashtë dimensioneve të qeverisjes si: llogaridhënia, stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës, efikasiteti qeverisës, cilësia rregullatore, shteti i së drejtës dhe kontrolli i korrupsionit. Kontrolli i korrupsionit jep përvojën dhe perceptimin e individëve të një vendi lidhur me korrupsionin si dhe “kapjen” e shtetit nga elitat dhe interesat private. Përveç sondazheve publike, IIG grumbullon të dhëna nga më shumë se 30 organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare dhe biznese në mbarë botën. Rezultatet janë të dobishme për krahasime midis shteteve të ndryshme dhe për vlerësimin e tendencave ndër vite, por IIG nuk mundëson identifikimin e specifikave sipas vendeve si dhe nuk ndihmon në formulimin e reformave lokale. Kontrolli i dimensionit të korrupsionit bazohet vetëm në të dhëna të përvojës dhe perceptimeve publike.

**Vlerësimi i politikave dhe kuadrit institucional, Banka Botërore<sup>11</sup>** kryhet çdo vit dhe mbledh të dhëna sasiore dhe cilësore. Ky mjet synon të vlerësojë cilësinë e politikave të një vendi dhe kuadrit institucional dhe masën se si këto politika dhe kuadri institucional i një vendi mbështet rritjen e qëndrueshme dhe reduktimin e varfërisë. Ky vlerësim përbëhet nga 16 kriteret ndër të cilët “Transparenca, Llogaridhënia dhe Korrupsioni në Sektorin Publik”. Ky mjet jep një përshkrim të detajuar se sa mirë buxhetet janë të lidhura me politikat dhe një pasqyrë të përgjithshme të kuadrit politik e institucional të një vendi. Për shkak të natyrës së ndjeshme të të dhënave, shpjegimet e detajuara të procesit të vlerësimit nuk janë të disponueshme për publikun dhe rezultatet nuk janë të krahasueshme me kalimin e kohës.

**Liria në botë/Freedom House<sup>12</sup>** i cili zhvillohet çdo vit në 210 shtete, përfshirë Shqipërinë, vlerëson aksesin e qytetarëve të një vendi në të drejtat politike dhe liritë civile si dhe analizon trendet nga viti në vit. Të dhënat mbledhen nga burime të ndryshme si akademikë politikëbërës, gazetarë, ekspertë e aktivistë të shoqërisë civile dhe shqyrtohen nga ekspertë/këshilltarë rajonalë. Treguesit i referohen 25 të drejtave të ndryshme politike dhe lirive civile dhe rezultatet janë të dobishme për të kuptuar faktorët nxitës të korrupsionit, mungesën e masave parandaluese apo të politikave antikorruption.

<sup>9</sup>Për më shumë shih: <https://www.traceinternational.org/trace-matrix>

<sup>10</sup>Për më shumë shih: <https://www.worldbank.org/en/publication/worldwide-governance-indicators>

<sup>11</sup>Për më shumë shih: <https://databank.worldbank.org/source/country-policy-and-institutional-assessment>

<sup>12</sup>Për më shumë shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world>

**Indeksi dhe Anketa e Buxhetit të Hapur (IABH)/International Budget Partnership<sup>13</sup>**, kryhet çdo dy vjet dhe të dhënat mbledhen mbi bazën e një pyetësoi gjithëpërfshirës i plotësuar nga një ose një grup studiuesish/akademikë/përfaqësues të shoqërisë civile vendase. Të gjitha përgjigjet për pyetjet e anketës janë të mbështetura me prova (psh dokumentet buxhetore; kuadri ligjor, deklaratat publike të zyrtarëve të ndryshëm ose të ekspertëve, etj.). Të dhënat kryqëzohen edhe me të dhënat nga dokumente buxhetore apo të transparencës financiare të publikuara nga institucionet ndërkombëtare (FMN, Banka Botërore, OECD). Anketa e Buxhetit të Hapur vlerëson transparencën buxhetore dhe praktikën e tjera buxhetore që kontribuojnë në llogaridhënien në një sistem të përgjegjshëm të financave publike sipas kriterëve të praktikave të mira të pranuar përgjithësisht për menaxhimin e financave publike në vendet anëmbanë botës. Shumica e pyetjeve të anketës vlerësojnë çfarë ndodh në praktikë duke e krahasuar me çfarë kërkohet nga ligji. IABH është një mjet unik për të vlerësuar disponueshmërinë dhe cilësinë e informacionit buxhetor të një vendi.

**Indeksi i Transformimit i zhvilluar nga Bertelsmann Foundation<sup>14</sup>** kryhet çdo 2 vjet duke angazhuar disa ekspertë vendas. Indeksi i Transformimit vlerëson nëse dhe se si vendet në zhvillim dhe transformim menaxhojnë ndryshimet sociale drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Në këtë kuadër, publikohen dy renditje, Indeksi i Statusit dhe Indeksi i Menaxhimit. Indeksi i Statusit vlerëson gjendjen politike dhe transformimin ekonomik të një vendi dhe rendit 137 shtetet në rrugën e tyre drejt demokracisë nën sundimin e ligjit dhe ekonomisë së tregut. Indeksi i Menaxhimit vlerëson cilësinë e qeverisjes, e cila përfshin mprehtësinë me të cilën vendimmarrësit drejtojnë proceset politike. Vlerësimet mbështeten në opinionet e ekspertëve të vendit. Të dhënat sasiore dhe cilësore të mbledhura ndihmojnë për të kuptuar specifikat, dobësitë dhe mangësitë në kuadrin ligjor dhe institucional.

**Indeksi i Transparencës/ERCAS and Hertie School of Governance<sup>15</sup>**, i cili në mënyrë periodike vlerëson transparencën në 128 vende, përfshirë Shqipërinë. Indeksi përmban dy grupe treguesish, "de jure" dhe "de facto". Rezultati për secilin shtet tregon nivelin në të cilin është përmbushur treguesi i "transparencës kundër korrupsionit". Për indeksin "de jure" vlerësohet ratifikimi dhe zbatimi i konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit ndërkohë që për të vlerësuar indeksin "de facto" përdoret një pyetësor që plotësohet nga ekspertë të fushës. Indeksi përdor të dhëna të publikuara në internet dhe nuk vlerëson burime të tjera institucionale.

---

<sup>13</sup>Për më shumë shih: <https://internationalbudget.org/open-budgetsurvey>

<sup>14</sup>Për më shumë shih: <https://bti-project.org/en/?&cb=00000>

<sup>15</sup>Për më shumë shih: <https://corruptionrisk.org/transparency/>

**Barometri Global i Korrupsionit (BGK), Transparency International<sup>16</sup>**, i cili zhvillohet çdo dy/tre vjet në nivel rajonal mbështetur në metodologji të ndryshme sipas specifikave rajonale. BGK bazohet në një sondazh të opinionit publik mbi perceptimet dhe përvojat e individëve për korrupsionin. Si një sondazh i opinionit publik, ai ofron një tregues se si shihet korrupsioni në nivel kombëtar dhe rajonal dhe se si përpjekjet për të frenuar korrupsionin, në mbarë botën, gjykohen në terren. BGK mund të përdoret për të identifikuar institucionet publike dhe shërbimet që shihen si të korruptuara. Megjithatë, BGK jep një referencë të përvojës dhe perceptimit të individëve për korrupsionin në institucione apo sektorë të ndryshëm por nuk sjell një vlerësim të kuadrit institucional.

**Anketat e Ndërmarrjeve, Banka Botërore<sup>17</sup>**, e cila zhvillohet çdo tre/katër vjet dhe është ndërtuar mbi një metodologji të mirëpërcaktuar të Bankës Botërore. Sondazhet kryhen nga kontraktorë privatë në emër të Bankës Botërore me pronarët dhe/ose menaxherët e lartë të bizneseve, kontabilistët dhe menaxherët e burimeve njerëzore. Kjo anketë mat perceptimet e kompanive lidhur me mjedisin e biznesit në një vend të caktuar dhe përvojën e tyre me procedurat shtetërore, duke përfshirë edhe pagesat informale dhe korrupsionin. Gjithashtu, anketa jep një vlerësim të numrit të bizneseve që e konsiderojnë korrupsionin si një pengesë kryesore për të bërë biznes në një vend të caktuar. Anketat e kompanive përfshin një numër të madh vendesh dhe të dhënat janë gjithëpërfshirëse, dhe mbulon si perceptimet ashtu edhe përvojat e korrupsionit.

**Eurobarometer:** Eurobarometri është instrumenti i anketave që përdoret nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe institucione dhe agjenci të tjera të BE-së për të monitoruar në mënyrë periodike opinionin publik për çështjet që lidhen me Bashkimin Evropian, si dhe qëndrimet e qytetarëve të natyrës politike ose sociale. Një ndër çështjet që është objekt i anketave është edhe perceptimi i qytetarëve ndaj korrupsionit në vendet e BE-së.

Nga shembujt e mësipërm rezulton se treguesit dhe metodologjitë për matjen e nivelit të korrupsionit janë të ndryshme dhe ofrojnë një mundësi për krahasime përtej kufijve të vendit pra, një krahasim midis vendeve të ndryshme në nivel global e rajonal. Megjithatë siç theksuam, këto të dhëna, nuk mund të ofrojnë një panoramë të saktë e të plotë të perceptimit publik të korrupsionit në një vend në këndvështrimin e reformave të ndërmarra, efikasitetit të politikës kombëtare, efikasitetit të kuadrit institucional dhe çështjeve specifike të një vendi. Të dhënat lokale mund të jenë më të dobishme strategjikisht sesa treguesit e përbërë global pasi duke u nisur nga problematikat kryesore në një vend nëpërmjet treguesve të kontekstualizuar mund të tregojnë problematika më specifike lidhur me performancën e institucioneve në drejtim të luftës kundër korrupsionit, rezultatin e reformave në këtë drejtim si dhe efikasitetin e politikave kombëtare kundër korrupsionit.

---

<sup>16</sup>Për më shumë shih: <https://www.transparency.org/en/gcb>

<sup>17</sup>Për më shumë shih: <http://www.enterprisesurveys.org/>

## 2.2. Matja e perceptimit të nivelit të korrupsionit në nivel kombëtar

Mbledhja e të dhënave të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme mbi korrupsionin në nivel kombëtar është thelbësore për monitorimin e tendencave të korrupsionit si dhe për të kuptuar format dhe nxitësit e tij. Përveç sondazheve dhe vlerësimeve të kryera në nivel ndërkombëtar, sondazhet për korrupsionin në nivel kombëtar mund të ofrojnë tregues të dobishëm, bazuar në opinionin dhe përvojën e publikut, për efektivitetin e politikave kombëtare, masave të ndërmarra dhe institucioneve/ mekanizmave kundër korrupsionit.

Matja e perceptimit dhe përvojës së qytetarëve për korrupsionin në nivel kombëtar është e rëndësishme për katër arsye kryesore:

- 1 Qeveria dhe ministri përgjegjës për antikorrupsionin duhet të mbledhin të dhëna dhe të vlerësojnë nivelin e korrupsionit në vend dhe tendencat e fenomeneve të caktuara me qëllim që ky informacion të bëhet publik për të gjithë. Kjo përfshin prodhimin e të dhënave që i shërbejnë si monitorimit ndërkombëtar të sipërcituar, por kryesisht të dhënave lokale që synojnë të tregojnë problematika më specifike lidhur me performancën në drejtim të luftës kundër korrupsionit, rezultatin e reformave në këtë drejtim si dhe efikasitetin e politikave kombëtare kundër korrupsionit.
- 2 Identifikimin e problematikave dhe fenomeneve të ndryshme lidhur me korrupsionin në vend dhe rrjedhimisht, në hartimin dhe miratimin e politikave dhe masave të nevojshme për të adresuar këto problematika.
- 3 Gjithashtu, informacioni i mbledhur nëpërmjet sondazheve publike për korrupsionin të bazuara në perceptimin dhe përvojën e individëve mund të jetë një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe masave kundër korrupsionit. Të dhënat mund të kontribuojnë në analizimin e efekteve të ndryshimeve të politikave dhe masave kundër korrupsionit si dhe mund të shërbejnë si bazë studimore gjatë hartimit të studimeve, analizave apo strategjive kombëtare.
- 4 Informimim aktiv i institucioneve publike dhe qytetarëve për nivelin e korrupsionit në vend dhe format e ndryshme që ai merr është me rëndësi vendimtare jo vetëm për sa më sipër, por edhe për të identifikuar sektorët e zonat gjeografike ku ky fenomen është më shqetësues, për të theksuar çdo progres të bërë si dhe për të sjellë të dhëna konkrete në çdo diskutim apo raportim mbi korrupsionin në vend. Gjithashtu, të dhënat do të shërbejnë edhe për të orientuar aktivitetet e natyrës edukuese dhe ndërgjegjëse kundër korrupsionit.

### 3. Metodatat për matjen e korrupsionit

Përpjekjet për të matur korrupsionin synojnë të zbulojnë natyrën dhe ndikimin e korrupsionit dhe janë të nevojshme për zhvillimin e politikave kundër korrupsionit. Matjet e korrupsionit mund të përdoren për të identifikuar tendencat, shkallën e shtrirjes dhe shtrirjen e llojeve të veçanta të korrupsionit. Matja e nivelit të korrupsionit është e rëndësishme, por njëkohësisht sfiduese duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin e fenomenit. Ka metoda të ndryshme për matjen e korrupsionit dhe secila prej tyre ka avantazhet dhe disavantazhet. Qasjet e ndryshme për matjen e korrupsionit klasifikohen në metoda direkte dhe indirekte.

1

Metodat direkte për matjen e korrupsionit synojnë mbledhjen e informacionit mbi korrupsionin bazuar në fakte, përmes procedurave statistikore dhe të standardizuara. Këto metoda masin përvojat konkrete të korrupsionit dhe përfshijnë të dhënat zyrtare (rastet e raportuara të korrupsionit, të dhënat e vendimeve gjyqësore, të dhënat administrative) dhe anketat e bazuara në përvoja që mbledhin të dhëna mbi përvojat e korrupsionit në një grup të caktuar të shoqërisë. Metodatat e drejtpërdrejta, të tilla si: pyetësorët/anketat e bazuara në përvoja, si dhe statistikatat e mbledhura përgjithësisht konsiderohen si qasja më e besueshme për prodhimin e informacionit të detajuar mbi korrupsionin, të nevojshëm për qëllime të politikëbërjes. Anketat e përvojës synojnë të masin eksperiencat personale të korrupsionit si për shembull duke pyetur qytetarët dhe bizneset nëse kanë dhënë ndonjëherë rryshfet ose janë përfshirë në ndonjë nga format e korrupsionit. Këto metoda janë të dobishme sepse synojnë të masin edhe nivelet e paraportuara të korrupsionit ose "shifrën e errët" të korrupsionit që nuk arrijmë ta evidentojmë nga statistikatat zyrtare.

2

Metodat indirekte të matjes së korrupsionit bazohen në nivelet e perceptuara të korrupsionit. Këto metoda përdoren, pasi matja e nivelit të korrupsionit bazuar në të dhëna empirike është e vështirë dhe jo gjithmonë tregon nivelin aktual të korrupsionit. Metodatat indirekte zakonisht bazohen në opinione dhe perceptime subjektive për nivelet e korrupsionit midis qytetarëve, përfaqësuesve të biznesit, nëpunësve civilë ose palëve të tjera të interesuara në një vend të caktuar. Ndër avantazhet e metodave indirekte për matjen e korrupsionit lidhen me faktin se mundëson krahasimin e të dhënave mbi nivelin e perceptimit të korrupsionit në grupe të ndryshme të shoqërisë.



**Një ndër klasifikimet e tjera i ndan në tre kategori metodat e matjes së nivelit të korrupsionit<sup>18</sup>:**

- Statistikat zyrtare dhe të dhënat administrative;
- Anketat e perceptimit dhe të qëndrimeve;
- Anketat e përvojës.

**Në tabelën numër 1, paraqiten në mënyrë skematike klasifikimet kryesore të metodave të matjes së korrupsionit.**




Tabela nr. 1: Metodat e matjes së korrupsionit

Megjithatë, matja e korrupsionit është e ndërlikuar nga vetë natyra dhe kompleksiteti i tij, interpretimet dhe perceptimet e ndryshme mbi korrupsionin dhe veprimtarinë korruptive, ndaj dhe kërkohet që të dhënat e mbledhura përmes një metode të vlerësohen në raport me ato të metodave të tjera.

Në lidhje me këto metoda të mbledhjes së të dhënave, për efekt të këtij instrumenti, anketat/ pyetësorët mbeten metoda kryesore që aplikohet në lidhje me perceptimin e qytetarëve mbi korrupsionin në vend, ndaj dhe në vijim do të fokusohemi tek to.

<sup>18</sup>Holmes (2015) "Corruption, a very short introduction"  
<https://etica.uazuay.edu.ec/sites/etica.uazuay.edu.ec/files/public/Corruption%20A%20Very%20Short%20Introduction%20by%20Leslie%20Holmes.pdf>



## 4. Të dhënat që synohen të mblidhen

Mbështetur në detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për antikorrupsionin synohet mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore, në mënyrë që t'i përgjigjen qëllimit dhe objektivave të këtij instrumenti metodologjik. Kështu, mund të synohet të mblidhen të dhëna lidhur me:

### Perceptimin për korrupsionin:

- informacion demografik mbi të anketuarin (gjinia, mosha, edukimi, të ardhurat, statusi familjar, punësimi, etj.);
- grupet më të cënueshme të popullsisë ndaj këtij fenomeni sipas entitetit gjeografik ose sipas karakteristikave të subjekteve ekonomike (sektori ekonomik, madhësia, etj.);
- mënyrën se si e kuptojnë të anketuarit korrupsionin/ sa shqetësues e konsiderojnë ata këtë fenomen për vendin/ krahasuar me 3-5 vite më parë a ka pasur progres apo regres/;
- format e korrupsionit që perceptohen si më të shpeshta (aktiv, pasiv, institucional, individual, i madh, i vogël, për të përfituar një shërbim të ligjshëm, për të përfituar një shërbim të paligjshëm, nepotizmi, klientelizmi, ndikimi i paligjshëm, abuzimi me detyrën dhe fondet, mosdeklarimi i konfliktit të interesit, etj);
- pranueshmërinë/papranueshmërinë e këtij fenomeni nga qytetarët/ format e korrupsionit që janë më të pranueshme prej tyre/ predispozitën e tyre për tu përfshirë në ndonjë nga format e korrupsionit/arsyet pse;
- faktorët që nxisin korrupsionin
- nivelin e korrupsionit sipas institucioneve publike, sektorëve publik dhe funksionit të zyrtarëve publik/ informacionin në të cilin bazohet vlerësimi për nivelin e korrupsionit;
- nivelin e njohurive të të anketuarve lidhur me mekanizmat ekzistues për denoncimin e rasteve të korrupsionit/vlerësimi i efikasitetit të këtyre mekanizmave;
- nivelin e reagimit të institucioneve përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit / vlerësimi i efikasitetit të institucioneve kundër korrupsionit në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e rasteve/;
- nivelin e besimit të publikut tek institucionet kundër korrupsionit/vlerësimin e rezultateve të reformave kundër korrupsionit;
- mënyrën se si të anketuarit e vlerësojnë kuadrin ligjor dhe politik kundër korrupsionit (përmbajtja dhe zbatimi)/ masat që duhen marrë për të përmirësuar situatën/ parashikimet e nevojshme;
- nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike/ problematikat e hasura/ masat që duhen marrë për të përmirësuar situatën;

- evidentimin e pasojave kryesore që sjell korrupsioni në vend;
- mënyrën se si përjetohet dhe perceptohet korrupsioni nga perspektiva gjinore, etj;

### **Përvojat lidhur me korrupsionin:**

- përvojën e individëve/bizneseve me raste të korrupsionit/në cilën cilësi (drejtpërdrejt, dëshmitarë, i afërm);
- identifikimin e institucioneve/shërbimeve/funksionarëve publik të përfshirë në korrupsion sipas rasteve;
- nivelin e raportimit të rasteve të korrupsionit në organet kompetente/ nëse jo, identifikimi i shkaqeve pse qytetarët ngurojnë të raportojnë korrupsionin/ nëse po, organet ku është raportuar rasti i korrupsionit;
- nivelin e reagimit të organeve kompetente ndaj rastit të korrupsionit të denoncuar/ hapat e ndërmarra dhe niveli i efikasitetit të veprimeve të ndërmarra/ ndëshkueshmëria e korrupsionit;
- nivelin e njohurive të të anketuarve lidhur me mekanizmat ekzistues për denoncimin e rasteve të korrupsionit/vlerësimi i efikasitetit të këtyre mekanizmave;
- mënyrën e qasjes së zyrtarëve publik dhe individëve në veprime korruptive/ reagimi i zyrtarëve publik dhe individëve ndaj veprimeve korruptive/pasojat e mospërfshirjes në veprime korruptive;
- veçoritë ose specifikat e fenomenit të korrupsionit si: koha kur është kryer korrupsioni para apo pas marrjes së shërbimit, lidhja midis qytetarit dhe funksionarit publik, shërbimi dhe/ose favori i kërkuar, niveli i denoncimit të rasteve, shpeshtësia e fenomenit, korrupsioni në sektorin privat, kostot e korrupsionit për individët apo bizneset, etj;
- vlerësimin e cilësisë së shërbimeve kryesore;
- përvojat e sektorit privat lidhur me korrupsionin e zyrtarëve publik në përgjithësi dhe në sektorë të veçantë, etj.

### **Qendrimet**

- vlerësimin mbi parashikimet e kuadrit ligjor (transparenca, llogaridhënia, integriteti, konflikti i interesit, hetimi dhe ndëshkueshmëria, kuadri institucional, etj)/nivelin e zbatueshmërisë së parashikimeve ligjore/identifikimin e problematikave në zbatimin e legjisllacionit/ mangësitë dhe nevojat për përmirësimin e legjisllacionit/ ekzistencën e procedurave burokratike që rrisin mundësinë për korrupsion/ ekzistencën e praktikave administrative që nuk mbështeten në legjisllacionin në fuqi, etj;

- vlerësimin mbi politikat antikorrupsion dhe masave të ndërmarra/efikasitetin e politikave anti-korrupsion dhe mangësitë dhe nevojat për përmirësimin e politikës shtetërore dhe masave të nevojshme/ përfshirjen e OSHC-ve në hartimin dhe përmirësimin e politikës antikorrupsion;
- identifikimin e faktorëve kryesorë nxitës të korrupsionit;
- vlerësimin e sektorëve me risk më të lartë për korrupsion, etj.;

## 5. Mënyrat e mbledhjes së të dhënave

Ka disa mënyra të mbledhjes së të dhënave që mund të përdoren për të mbledhur informacion mbi perceptimin e publikut për antikorrupsionin. Përzgjedhja e metodës varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë natyrën e kërkimit, popullsinë e synuar, burimet e disponueshme dhe elementet që do të vlerësohen. Metodatat e zakonshme të mbledhjes së të dhënave janë:

### *Anketat dhe pyetësorët:*



Anketat dhe pyetësorët në internet:

Platformat online përdoren për të shpërndarë anketa që synojnë të masin perceptimin e një numri të madh të qytetarëve. Kjo metodë mundëson shpërndarjen e anketës në një kohë më të shpejtë, është me kosto efektive dhe lejon përpunimin e lehtë të të dhënave. Në kushtet e digjitalizimit të shërbimeve ndaj qytetarëve anketat/pyetësorët online përbëjnë mënyrën më efektive për matjen e perceptimit të qytetarëve. Linku i pyetësorëve/ anketave mbi perceptimin e korrupsionit mund të publikohet në faqen Web të institucioneve, platformave që përdoren për ofrimin e shërbimeve ose paraqitjen e ankesave.



Anketat dhe pyetësorët në letër:

Shpërndarja e anketave në letër personalisht ose me postë mund të jetë e përshtatshme për zonat me akses të kufizuar në internet.

### *Intervistat:*



Intervistat e strukturuar:

Kryerja e intervistave një-në-një me një grup pyetjesh të paracaktuara siguron qëndrueshmëri në mbledhjen e të dhënave. Ndryshe quhen edhe intervista të standartizuara.

### Intervistat gjysmë të strukturuar:

Kombinojnë pyetje të hapura dhe të mbyllura për të marrë informacion më të detajuar. Kjo intervistë lejon përgjigje të hapura nga pjesëmarrësit për informacion më të thelluar, duke lejuar që temat dhe idetë të shfaqen në mënyrë organike, e ku mund të mblidhen të dhëna të pasura prej tyre.

### *Fokus Grupet:*

 Kjo metodë inkurajon pjesëmarrësit të shprehin mendimet dhe perceptimet e tyre për sa u përket akteve korruptive. Ajo konsiston në mblidhjen së bashku të një grupi të vogël pjesëmarrësish për të diskutuar çështjet kundër korrupsionit, duke pasur parasysh dinamikën dhe sinergjinë e grupit.

### *Vrojtimi:*

 Vëzhgimi i drejtpërdrejt i ngjarjeve publike, takimeve ose ndërveprimet që lidhen me antikorrupsionin japin një panoramë e pasqyrimin të këtij fenomeni dhe reagimit ndaj tij në opinionin publik.

### *Analiza e mediave sociale:*

 Analizimi i platformave të mediave sociale për të kuptuar perceptimin e shoqërisë ndaj korrupsionit është një metodë që mundëson marrjen e informacionit në kohë reale.

### *Kërkimet social-kulturore:*

 Kërkimet social-kulturore që kryhen nga hulumtuesit në komunitet për të kuptuar kontekstin social dhe kulturor të korrupsionit janë një metodë e cila jep një informacion më të thelluar të kontekstit lokal të këtij fenomeni.

### *Analiza e dokumentacionit:*

 Shqyrtimi i dokumenteve përkatëse ku përfshihen raportet e institucioneve shtetërore, raportet e organizmave ndërkombëtare apo entiteteve të tjera dhe mbulimi mediatik në lidhje me antikorrupsionin mund të sigurojë kontekstin historik dhe të plotësojë burime të tjera të të dhënave.

### *Platformat e Angazhimit Qytetar:*

 Përdorni platformat ose forumet e angazhimit qytetar në internet për të mbledhur opinione dhe reagime nga komuniteti. Kjo metodë mund të jetë efektive për të arritur një audiencë të ndryshme.

### *Sondazhet Telefonike:*

 Kryeni sondazhe përmes telefonit për qytetarë që mund të mos kenë akses në internet ose preferojnë këtë mënyrë komunikimi.

### ***Bashkëpunimi me OSHC-të dhe drejtuesit e njësive vendore:***



Punoni me organizatat e shoqërisë civile dhe drejtuesit e njësive vendore për të mbledhur informacion. Kjo qasje bashkëpunuese mund të rrisë besimin dhe pjesëmarrjen.

### ***Qasje me metoda të përziera:***



Kombinoni metoda të shumta të mbledhjes së të dhënave për të krahasuar gjetjet dhe për të siguruar një kuptim më të plotë të perceptimit publik. Kur zgjidhni një metodë të mbledhjes së të dhënave, merrni parasysh avantazhet dhe kufizimet e secilës, si dhe karakteristikat specifike të popullatës së synuar. Rregullat e etikës, marrja e pëlqimit, mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti duhet të udhëheqin qasjen tuaj. Mund të jetë gjithashtu e dobishme të testoni metodën tuaj të zgjedhur për të identifikuar dhe adresuar çdo çështje të mundshme përpara zbatimit në shkallë të plotë.

## **6. Fokus grupet**

Fokus grupet bëjnë pjesë në metodat kërkimore kualitative, që konsistojnë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave jonumerike, për të kuptuar qëndrimet, opinionet dhe eksperiencat.

Fokus grupet na mundësojnë të kuptojmë dimensione të ndryshme konceptuale të fenomenit të korrupsionit dhe të marrim të dhëna më të detajuara. Kjo metodë inkurajon pjesëmarrësit të shprehin mendimet dhe perceptimet e tyre për sa i përket këtij fenomeni.

Pjesëmarrësve mund t'u drejtohen pyetje të ndryshme që lidhen me korrupsionin si për shembull çfarë është korrupsioni për ta, si ndikon korrupsioni në shoqëri, cilat janë institucionet më të prekura nga korrupsioni, cilat janë pikëpamjet e tyre për rolin e qytetarëve dhe palëve të ndryshme të interesit në zgjidhjen e kësaj çështjeje, si i vlerësojnë mjetet dhe mekanizmat ekzistues kundër korrupsionit dhe si mund të përmirësohen për të qenë më efektive etj.

Në krahasim me anketat nga të cilët mblidhen më shumë të dhëna rreth perceptimeve, qëndrimeve dhe përvojave të njerëzve, në rastet kur është e nevojshme të studiohen konceptet në një nivel më të thellë, atëherë përdoren fokus grupet.

Realizimi i një fokus grupi kalon nëpër hapat si më poshtë:

- Përcaktimi i fokus grupit;
- Hartimi dhe përgatitja e pyetjeve që do të diskutohen;
- Përzgjedhja e pjesëmarrësve;
- Zhvillimi e fokus grupit;
- Analizimi i të dhënave.

Në përcaktimin e fokus grupit duhet mbajtur në konsideratë se fokus grupi është një grup i vogël i përbërë nga 6 deri 10 persona, organizuar si një diskutim i hapur i drejtuar nga një moderator. Numri i anëtarëve në grup duhet të jetë mjaftueshëm i madh sa për të krijuar një diskutim të pasur, por jo aq i madh sa disa pjesëmarrës të lihen jashtë diskutimit. Moderator i fokus grupit nxit diskutimin e hapur dhe spontan me qëllim që të merren sa më shumë ide dhe mendime të ndryshme gjatë kohës së caktuar për zhvillimin e fokus grupit. Numri i pyetjeve që mund të diskutohen në një fokus grup varion nga 8 deri në 10. Rekomandohet që pjesëmarrësit e fokus grupeve nuk duhet të njihen paraprakisht me pyetjet që do t'u drejtohen.

Koha ideale për t'u caktuar për zhvillimin e një fokus grup varion nga 45 deri në 90 minuta sepse përtej kësaj kohe shumica e grupeve nuk janë më produktive. Duhet zhvilluar më shumë se një fokus grup për çdo temë për të prodhuar rezultate të vlefshme – zakonisht tre ose katër. Në rastet e fokus grupeve që kanë si qëllim të kuptojnë qëndrimet dhe perceptimet mbi korrupsionin mund të diskutohen të njëjtat pyetje me grupe të ndryshme të shoqërisë me qëllim kryerjen e një analize krahasuese.

Gjithashtu metoda e fokus grupeve mund të përdoret si një fazë paraprake para realizimit të anketave në mënyrë që të përcaktojmë çështjet dhe pyetjet që do të adresohen me anë të anketës<sup>19</sup>.



<sup>19</sup>Using a three-stage focus group design to develop questionnaire items for a mass survey on corruption and austerity: a roadmap" Luis de Sousa, Isabel R. Pinto and Felipe Clemente and Gustavo Gouvea Maciel, 2020.



## 7. Anketat/pyetësorët për korrupsionin

Treguesit e bazuar në anketa/pyetësor janë mjete shumë të rëndësishme për të matur përvojat e drejtpërdrejta të fenomenit të korrupsionit. Anketat e bëra me qytetarë dhe biznesin janë thelbësore për të matur shkallën dhe përhapjen e korrupsionit, duke përfshirë rastet e pa raportuara të korrupsionit, dhe për të identifikuar faktorët e rrezikut, dinamikën e korrupsionit dhe kontekstin ku ai ndodh. Këto anketa/pyetësorë mund të zhvillohen fizikisht apo online.

Anketat e korrupsionit gjithashtu mund të ofrojnë njohuri mbi qëllimin dhe mënyrën e kryerjes së korrupsionit, të cilat janë të rëndësishme kur vlerësohet se si të përmirësohet ofrimi i shërbimeve publike për reduktimin e mundësive për të kryer akte korruptive. Për shembull, kur të dhënat për korrupsion tregojnë se ryshfeti përdoret për të përshpejtuar procedurat administrative, futja e sistemeve transparente për gjurmimin e fillimit dhe përfundimit të procedurave administrative apo sisteme monitoruese, mund të zvogëlojë mundësitë për korrupsion.

Anketat me qytetarë dhe biznese janë një ndër mënyrat për të matur nivelin e perceptuar të korrupsionit. Megjithatë, treguesit e perceptimit që hulumtojnë opinionin publik mbi korrupsionin, edhe pse janë të rëndësishëm veçanërisht si pasqyrë e efikasitetit të perceptuar të politikave kryesore nga ana e publikut, mund të ndikohen nga jehona e gjerë mediatike. Përmes pyetësorëve/anketave merren informacione që lidhen me nivelin e perceptuar të korrupsionit dhe faktorët kontekstualë që kontribuojnë dhe nxisin korrupsionin.

'Matjet' e korrupsionit në përgjithësi përpiqen të përcaktojnë shkallën e shtrirjes së korrupsionit në mënyra e forma të ndryshme. Vlerësimet nga ana tjetër, synojnë të përshkruajnë karakteristikat e një konteksti të caktuar, mangësitë dhe pikat e forta të sistemit dhe faktorët politikë, ekonomikë dhe socialë që ndikojnë në nivelin e korrupsionit në një vend apo në një situatë të caktuar.

Sigurisht që aspekti matës sasior është me rëndësi edhe për efekt të korrupsionit dhe matjes së tij, por elementi sasior kërkon patjetër edhe qasjen analitike që lidhet p.sh. me nxjerrjen më mirë në pah të të drejtave të njeriut, efektivitetit të qeverisjes, nivelet e korrupsionit, etj. Ndaj në përdorimin e këtij instrumenti vlen të theksohet se matja e korrupsionit bëhet duke plotësuar të dhënat empirike me lloje të tjera vlerësimi.





## 7.1. Kategoritë kryesore të anketave për korrupsionin

Në aspektin e metodologjisë dhe instrumenteve matëse kur bëhet fjalë për marrjen e opinionit publik mbi korrupsionin, pyetësorët si instrumente matëse synojnë të mbledhin të dhëna që lidhen me perceptimin e publikut mbi korrupsionin dhe eksperiencën personale me veprimet korruptive. Ndaj dhe anketat hartohen mbi bazën e pyetjeve që lidhen me këto dy aspekte të marrjes së mendimit të publikut mbi korrupsionin dhe përhapjen e tij në shoqëri.

Shumica e anketave për korrupsionin priren të bien nën një ose më shumë nga tre kategoritë e mëposhtme:

**Anketat e perceptimit të korrupsionit** synojnë të mbledhin më shumë të dhëna subjektive mbi pikëpamjet/opinionet e individëve mbi fenomenin e korrupsionit në vend si dhe mbi efektivitetin e politikave dhe masave kundër korrupsionit. Të dhënat e perceptimeve përbëhen nga opinionet e qytetarëve të zakonshëm, përfaqësuesve/pronarëve të bizneseve ose ekspertëve për tema specifike. Këto anketa janë të rëndësishme edhe për të vjelë të dhëna siç është besimi i publikut tek institucionet apo për të marrë mendimin e qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara apo performancën qeverisëse.


**Anketat e përvojës së korrupsionit** që synojnë të mbledhin të dhëna bazuara në përvojën e drejtpërdrejtë të individëve lidhur me korrupsionin dhe ndikimin e këtij fenomeni në jetën e tyre të përditshme. Të dhënat përfshijnë përvoja (ose njohuri) specifike të qytetarëve. Kjo përfshin shpeshtësinë e fenomenit, identifikimin e institucioneve/sectorëve më të prekur nga korrupsioni, kostot, nivelin e njohurive të individëve për kuadrin ligjor, politikat ose praktikat specifike. Gjithashtu, këto anketa janë të dobishme për matjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve, nivelin dhe format e korrupsionit në sektorë të caktuar. Gjithashtu, anketa duhet t'i shërbejë edhe identifikimit të problematikave dhe vështirësive me qëllim marrjen e masave të nevojshme për t'i adresuar ato. Këto anketa mund të përdoren edhe për të mbledhur të dhëna nga një kategori specifike e individëve si për shembull përfaqësues apo pronarë të bizneseve në vend.

Të tre këto kategori mund të ndërthuren kur synohet mbledhja e të dhënave të ndryshme. Shumë metodologji kombinojnë lloje të ndryshme të dhënash për të mbledhur më mirë informacion rreth temës që studiohet.

## 7.2. Hapat për realizimin e anketës/pyetësorit

Një pyetsor/anketë është një ndërmarrje komplekse në të cilën duhet të zbatohen disa aktivitete dhe të përfshihen një sërë aktorësh. Pyetësori/anketa si instrument për zhvillimin e një studimi të korrupsionit duhet të mbulojë të gjitha aktivitetet përkatëse dhe disa zgjedhje strategjike kanë një peshë të veçantë në përcaktimin e kostos së përgjithshme.

Realizimi i një pyetësoi kalon nëpërpjermjet hapave si më poshtë:



1

### ***Përcaktimi i Qëllimit:***

Kuptoni qëllimin dhe objektivat e studimit tuaj dhe përcaktoni çfarë informacioni ju nevojitet në lidhje me perceptimin dhe përvojat e publikut ndaj korrupsionit dhe se si ky informacion mund të ndihmojë në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e mjeteve dhe mekanizmave kundër korrupsionit.

2

### ***Përzgjedhja e Metodës së Mbledhjes së të Dhënave:***

Zgjidhni një metodë të përshtatshme për të mbledhur të dhënat. Kjo mund të përfshijë pyetësorë, intervista, fokus grupet, analiza e mediave sociale, etj. Përzgjedhja e metodës do të varet nga natyra e pyetjeve tuaja dhe burimet që keni në dispozicion. Duhet mbajtur në konsideratë se intervistat ballë për ballë sjellin më tepër kosto dhe kërkojnë më shumë kohë. Ndërkohë anketimi online redukton kohën dhe është më efektive, por vështirësia këtu mund të lidhet me faktin se sa të familjarizuar janë grupe të caktuara qytetarësh në përdorimin e internetit dhe aksesin në të. Intervistat/anketimet telefonike po ashtu janë më pak të kushtueshme sesa ato që zhvillohen fizikisht (ballë për ballë). Ndaj, forma më e përshtatshme, mund të ishte një kombinim mes pyetësorëve (ballë për ballë) mbi bazë kampionimi dhe formës elektronike (online) përmes internetit.

3

### ***Hartimi i Pyetësoit ose Strukturës së Intervistës:***

Nëse përdorni pyetësor, hartoni një listë me pyetje të strukturuar dhe të qarta. Nëse përdorni intervista, përgatituni me pyetje të hapura dhe teknika për të lehtësuar diskutimin.

**4*****Pilotimi i Pyetësorit ose Intervistës:***

Pilotoni pyetësorin ose strukturën e intervistës me një grup të vogël testuesish për të identifikuar çdo problem potencial dhe për të bërë përmirësime.

**5*****Realizimi i anketës pyetësorit:***

Realizoni pyetësorin, intervistat, apo metodën tjetër të përzgjedhur për të mbledhur të dhënat duke siguruar që procesi të jetë transparent për pjesëmarrësit.

**6*****Analiza e të dhënave të mbledhura***

Pasi të keni mbledhur të dhënat, filloni procesin e kodifikimit dhe kategorizimit. Identifikoni temat dhe përgjigjet kyçe për secilën pyetje.

**7*****Analiza sasiore e të dhënave:***

Nëse përdorni një pyetësor me përgjigje të strukturuar, përdorni mjete statistikore për të analizuar rezultatet kuantitative (sasiore). Kjo mund të përfshijë ndarjen e përgjigjeve sipas grupmoshës, niveleve të arsimit, etj

**8*****Analiza cilësore e të dhënave:***

Në rastin e pyetjeve të hapura apo intervistave, analizoni rezultatet përmes një analize cilësore identifikoni modelet, tendencat, dhe përshtypjet që dalin nga përgjigjet.

**9*****Hulumtimi i lidhjeve mes variablave:***

Përpikuni të kuptoni lidhjet midis variablave dhe të identifikoni arsyet pse një pjesë e publikut mund të ketë një perceptim të caktuar ndaj korrupsionit.

**10*****Përgatitja e Raportit:***

Përgatituni për të shkruar një raport të detajuar të rezultateve. Përfshini një shpjegim të qartë të metodologjisë, rezultateve, dhe interpretimin tuaj të perceptimit të publikut ndaj korrupsionit.

**11*****Prezantimi dhe Komunikimi i Rezultateve:***

Nëse është e mundur, prezantoni rezultatet në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për audiencën e synuar. Komunikoni gjetjet, konkluzionet, dhe rekomandimet që dalin nga studimi juaj.

## **8. Metodat e kampionimit**

Në lidhje me kampionimin nisur dhe nga instrumentet ndërkombëtarë të matjes së perceptimit të antikorrupsionit synohet përfshirja e personave 18 vjeç e sipër. Mostra/kampionimi duhet të zgjidhet në mënyrë që të jenë përfaqësuese sipas moshës, gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike, pasi grupe të popullsisë mund të preken nga nivele dhe lloje të ndryshme korrupsioni.

Në anketat e popullsisë, njësia përfundimtare e kampionimit është individi. Ndërsa "kampionimi i shtresëzuar" përdoret shpesh në anketat e korrupsionit në familje ku familja është njësi e ndërmjetme. Metodatat e tjera të njohura të kampionimit përfshijnë "kampionimin në grup", "kampionimin proporcional me madhësinë" dhe "kampionimin me disa faza". Ekzistojnë disa metodologji për shpërndarjen optimale të një kampioni nëpër disa shtresa, ose për llogaritjen e madhësive të kërkuara të mostrës për secilën shtresë.

Përzgjedhja e duhur e të anketuarve është çelësi për të garantuar besueshmërinë e rezultateve të anketës për korrupsionin. Duke qenë se anketat e popullsisë synojnë individët (dhe jo familjet), kur njësia e ndërmjetme e kampionimit është në nivel familjeje, procesi i përzgjedhjes së të anketuarit duhet të jetë transparent dhe i rastësishëm. Për të lehtësuar përzgjedhjen e rastësishme, pasi të zgjidhet një familje nga korniza, duhet të mbledhet informacioni bazë i nevojshëm për çdo individ që jeton në atë familje. Kjo ka një rëndësi të madhe pasi mundëson llogaritjen e probabilitetit që çdo njësi kampionimi të përfshihet në kampion dhe, në këtë mënyrë, peshat e kampionimit të përdorura në fazën e vlerësimit të llogariten siç duhet. Për të siguruar saktësi më të mirë të rezultateve, rekomandohet përdorimi i individit si njësi kampionimi.

Sipas instrumentit të Bashkimit Evropian (Eurobarometer) për realizimin e anketave zgjidhet një kampion prej të paktën 1000 qytetarëve për çdo shtet. Një madhësi kampioni prej 500 personash përdoret në vendet ose territoret me një popullsi nën një milion banorë.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë popullsinë në vendin tonë vlerësojmë se në nivel kombëtar një kampion prej 1000–1500 qytetarësh të kategorive të ndryshme do të ishte e pëlqyer në një hark të caktuar kohor prej disa muajsh.

## 9. Dizajnimi i Pyetësorit

Vendosja e qartë e qëllimeve është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në procesin e zhvillimit të anketës/pyetësorit. Zgjedhjet kryesore metodologjike (p.sh. dizajni dhe ërzgjedhja e kampionit; hartimi dhe përmbajtja e pyetësorit; metoda e mbledhjes së të dhënave) varen nga qëllimet e anketës.

Qëllimet e anketës/pyetësorit pasqyrojnë nevojat e palës së interesuar në lidhje me çështje specifike dhe ofrojnë bazën për zhvillimin e anketës. Prandaj, zgjedhja e qëllimeve të anketës ndikohet në mënyrë të pashmangshme nga institucioni që kryen anketën.

Organet publike kanë nevojë për informacion bazë mbi nivelin e korrupsionit në përgjithësi apo në shërbime publike specifike në mënyrë që të zhvillohen politika parandaluese ose sanksionuese; sigurimin e të dhënave të përgjithshme mbi prevalencën dhe veçoritë kryesore të fenomenit. Zgjedhja e qëllimeve të anketës përcakton zgjedhjen e popullatës së synuar (individët ose bizneset, për shembull) dhe qasjen metodologjike.

Përveç synimit bazë të sugjeruar dhe objektivave të lidhura me to, ministria përgjegjëse për antikorrupsionin mund të vendosë nëse do të adresojnë synime të tjera për të mbuluar nevojat specifike kombëtare. Për shembull, përveç trajtimit të korrupsionit dhe formave të ndryshme të shfaqjes së tij në sektorin publik, mund të përfshijë gjithashtu pyetësorë për të hetuar përvojën me korrupsionin brenda sektorit privat.

Çështjet kryesore që mund të adresohen në pyetësorët për publikun e që lidhen me qëllimin e tij janë:

- Përvoja personale me korrupsionin;
- Perceptimi dhe përvoja indirekte e korrupsionit;
- Përvoja personale e korrupsionit në sektorin publik;
- Qasja e perceptuar dhe cilësia e shërbimeve publike;
- Përvoja personale/direkte e formave të tjera të korrupsionit;
- Perceptimi për punën e qeverisë kundër korrupsionit;
- Përvoja personale e nepotizmit në sektorin publik;
- Përvoja personale e korrupsionit në sektorin privat;

Qëllimet dhe objektivat e anketës/pyetësorit duhet të përkthehen në pyetje në mënyrë që të marrim informacionin e nevojshëm nga të anketuarit. Procesi i përzgjedhjes së pyetjeve, formulimit në mënyrë të qartë dhe konciz, ndërtimi i një strukture logjike të pyetjeve është shumë i rëndësishëm.

Lloji i pyetjeve të bëra, mënyra se si janë formuluar dhe mënyra se si janë renditur mund të ndikojnë ndjeshëm në përgjigjet ndaj një ankete.

Në hartimin e pyetësorit duhen mbajtur në konsideratë tre elementët si më poshtë:

- Dizajnimi i opsioneve të përgjigjes
- Formulimi i Pyetjeve
- Efekti i renditjes së pyetjeve<sup>20</sup>

---

<sup>20</sup>Manual On Corruption Surveys, "Methodological guidelines on the measurement of bribery and other forms of corruption through sample surveys", 2018, page 54

[https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/CorruptionManual\\_2018\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/CorruptionManual_2018_web.pdf),

Renditja e pyetjeve ndikon në përgjigjet e të anketuarve dhe rrjedhimisht rezultatet e anketës. Në veçanti, pyetjet që janë vendosur më herët në pyetësor mund të ndikojnë në përgjigjet e dhëna për pyetjet që vijnë më vonë. Preferohet që temat e para të lidhen me qëndrimet, perceptimin dhe kuptimin e korrupsioni dhe mbi cilësinë dhe aksesin në shërbimet publike dhe në vijim të renditen pyetjet që fokusohen në përvojat në lidhje me korrupsionin.

## 10. Pilotimi i pyetësorit

Pyetësorët pilot ndihmojnë në identifikimin e pengesave në lidhje me realizimin e pyetësorit, përcaktimin e efikasitetit të formulimit të pyetjeve në lidhje me perceptimin dhe përvojat e korrupsionit të intervistuesve, efektit të renditjes së pyetjeve dhe nivelin e bashkëpunimit të të anketuarve. Gjatë një pyetësori pilot të gjitha fazat e një pyetësori testohen në një numër të vogël të anketuarish.

Në rastin e Shqipërisë, një variant pilotimi mund të ishte ai që lidhet me moshën dhe gjininë për të parë perceptimin edhe të të rinjve mbi çështje që lidhen me korrupsionin dhe përhapjen e tij, integritetin dhe etikën etj. (P.sh.100–200 për kategori).

Një variant tjetër (ose kombinim i të dyve) mund të ishte në bazë të sektorëve të caktuar dhe problematikave që lidhen me ta (p.sh. shëndetësia, drejtësia, prokurimet publike dhe niveli i korrupsionit në to, etj).

Në rastin e pilotimit, kampioni varion sipas specifikave të grupit që targeton. Ajo që duhet theksuar është se përzgjedhja e kampionit të të anketuarve varet gjithashtu edhe nga shtrirja në hapësirë dhe kohë, mjetet dhe burimet në dispozicion. Hapat në të cilat duhet të kalojë pilotimi i një pyetësori janë si më poshtë:






Tabela nr. 2: Pilotimi i pyetësorit

Siç evidentohet edhe në skemën e mësipërme hapi i parë për pilotimin e pyetësorit është identifikimi i fokus grupit. Zgjidhni një grup të vogël të të testuarve që përfaqësojnë audiencën e përfshirë në studim. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrës të mundshëm ose persona që kanë eksperiencë në fushën e kërkimit tuaj. Përpara se të fillojë pilotimi është e rëndësishme të informoni të anketuarit mbi qëllimin e pyetësorit dhe tu bëhet me dije se janë në fazën e pilotimit dhe jo të kryerjes së pyetësorit zyrtar. Pilotimi duhet të kryhet në një mjedis që i afrohet sa më shumë ambientit real ku do të zbatojnë pyetësorin përdoruesit e vërtetë. Kjo mund të përfshijë platformën e përdorur për mbledhjen e të dhënave.

Pasi testuesit kanë plotësuar pyetësorin, mblidhni komente dhe sugjerime nga ata rreth cilësisë së pyetjeve, qartësisë, dhe ndonjë shqetësimi që kanë hasur dhe përdorni këto komente për të përmirësuar dhe rregulluar pyetësorin. Gjithashtu verifikoni kohën që merr secila përgjigje dhe nëse disa pyetje shkaktojnë vështirësi ose marrin shumë kohë për t'u përgjigjur, mund të jetë e nevojshme të shkurtohen ose riformulohen.

Sigurohuni që pyetjet janë të qarta dhe të kuptueshme për testuesit me qëllim evitimin e fjalëve të komplikuar ose pyetjeve që mund të çojnë në keqkuptime. Nëse është e mundur, pilotoni me grupe të ndryshme të testuesve për të parë se si pyetësori përdoret dhe kuptohet në kontekste të ndryshme.

Nëse pyetësori përdor një platformë teknologjike, sigurohuni që funksionon si duhet dhe nuk ka probleme teknike që mund të ndikojnë në përgjigjet e përdoruesve. Bëni ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në pyetësor, pastaj zbatoni një raund të dytë të pilotimit për të verifikuar se ndryshimet kanë pasuar ndonjë ndikim pozitiv.



Në përfundim të pyetësorit pilot duhen vlerësuar aspektet që lidhen me kriteret për përzgjedhjen e të anketurve, metodat e mbledhjes së të dhënave, numri i pyetjeve për të cilat nuk janë dhënë përgjigje, kohëzgjatjen e anketës dhe gjithëpërfshirjen. Në varësi të rezultateve të pilotuara, mund të bëhet projeksioni më i mirë për ta shtrirë matjen më gjerë dhe për të marrë rezultate më të plota.

## 11. Parimet e etikës dhe profesionalizmit gjatë realizimit të anketës

Gjatë realizimit të pyetësorëve duhet të respektohet etika në komunikim, marrja e pëlqimit nga pjesëmarrësit në pyetësor si dhe ruajtja e konfidencialitetit dhe anonimatit për të anketuarit, duke e shpjeguar qartë këtë gjë.

Nisur nga specifikat që ka korrupsioni si fenomen, është me rëndësi ndërtimi i besimit mes palëve (intervistuesit dhe të intervistuarit), ndaj dhe merr rëndësi personi që zhvillon pyetësorin dhe sa i familjarizuar apo i trajnuar është ai për përdorimin e tyre, me qëllim marrjen e rezultateve të pritshme të besueshme dhe objektive.

Në rastin e zhvillimit të pyetësorëve në lidhje me korrupsionin, i kushtohet vëmendje edhe atyre që realizojnë këto pyetësorë dhe trajnimit të përshtatshëm të tyre për këtë qëllim. Veçanërisht theksi vihet tek elementë të tillë si: mosha dhe gjinia, diversiteti i individëve që realizojnë pyetësorin, origjina, arsimimi, aftësitë e intervistimit, integriteti dhe eksperiencia të mëparshme.



Gjatë realizimit të pyetësorit duhen mbajtur në konsideratë rregullat e etikës si vijon:



### ***Respektimi i Pjesëmarrësve:***

Tregohuni të kujdesshëm dhe respektoni të gjithë pjesëmarrësit dhe të drejtat e tyre individuale. Kujdesuni që të dhënat e tyre të trajtohen me ndjeshmëri dhe pa shkelur privatësinë e tyre.



### ***Përcaktimi i Qartë të Qëllimeve:***

Sigurohuni që qëllimet dhe objektivat e hulumtimit ose aktivitetit të jenë të qarta dhe të drejtpërdrejta dhe mos fshihni qëllimet e vërteta ose rezultatet e mundshme.



### ***Evitimi i Konfliktit të Interesit:***

Identifikoni dhe trajtoni çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në objektivitetin e hulumtimit apo në vlerësimin e situatave profesionale.



### ***Përdorimi i Metodologjive dhe Burimeve të Përshtatshme:***

Sigurohuni që metodologjia dhe burimet që përdorni janë të përshtatshme, të besueshme dhe në përputhje me standardet etike dhe profesionale.



### ***Transparenca***

Tregoni një nivel të lartë të transparencës në të gjitha fazat e studimit tuaj, duke përfshirë hartimin e pyetësorit, metodologjinë, dhe interpretimin e rezultateve.



### ***Përdorimi i të dhënave me kujdes:***

Përdorni të dhënat me kujdes dhe në përputhje me qëllimet e deklaruar të studimit duke mbajtur në konsideratë se të dhënat përfaqësojnë individë dhe duhen trajtuar me respekt dhe kujdes.



Profesionalizmi gjatë realizimit të pyetësorit përfshin elementët si më poshtë:



### ***Përdorimi i Burimeve të Vlefshme:***

Sigurohuni që të dhënat dhe informacionet që përdorni janë të vlefshme, të verifikuara dhe të mbështetura nga burime të besueshme.



### ***Komunikimi Efektiv:***

Komunikoni me ndjeshmëri dhe efektivitet me të gjithë pjesëmarrësit, kolegët dhe publikun tuaj. Sigurohuni që të dhënat dhe rezultatet e hulumtimit të komunikohen në një mënyrë të kuptueshme dhe të drejtpërdrejtë.



### ***Përgjegjshmëria Profesionale:***

Pranojeni përgjegjësinë për veprimtarinë tuaj profesionale dhe trajtoni situatat që mund të shfaqen gjatë realizimit të pyetësorit/anketës me integritet dhe përgjegjësi.



### ***Pjesëmarrje në aktivitete profesionale të vazhdueshme:***

Informohuni vazhdimisht mbi zhvillimet e fundit në fushën tuaj dhe përmirësoni në mënyrë periodike aftësitë tuaja përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera profesionale.

Mbajtja në konsideratë e etikës dhe profesionalizmit ndihmon në ndërtimin dhe ruajtjen e besimit publik, ndërtimin e një imazhi të mirë profesional dhe në zbatimin e praktikave të mira në fushën tuaj të veprimtarisë.



## 12. Analiza e të dhënave

Anketat mbi korrupsionin mundësojnë akses të drejtpërdrejtë për ata që kanë përjetuar korrupsionin. Për këtë arsye, informacioni mund të mbledhet për variablin e interesit (siç është përvoja e korrupsionit) si dhe mbi disa karakteristika, sjellje dhe dukuri që lidhen me të.

Për shembull, informacioni i detajuar mbi individët e prekur dhe sfondi i tyre demografik, social dhe ekonomik mund të ndihmojë në identifikimin nëse veçoritë specifike të ekonomisë familjare, individuale, biznesit ose vendit e rrisin ose reduktojnë rrezikun e korrupsionit. Për më tepër, duke kërkuar informacion për llojin e zyrtarit publik ose entit privat të përfshirë (p.sh., oficerët e doganave, punonjësit e policisë, zyrtarët e taksave/tatimeve, gjykatës, etj.), për situatën ose procedurën administrative/apo të ndjekur nga biznesi gjatë së cilës është kërkuar/po ofrohet korrupsioni (ryshfeti) (p.sh., prokurimi publik, dogana, marrja e lejeve të ndërtimit) ose për arsyen e kërkesës së tij (p.sh. përshpejtimi i procedurës, përfitimi i një avantazhi ndaj pjesëmarrësve të tjerë në një ofertë tenderi), është e mundur të fitohet një kuptim gjithëpërfshirës i mekanizmit të korrupsionit.

Të gjitha këto detaje janë thelbësore për të kuptuar dhe analizuar faktorët nxitës dhe dobësitë ndaj korrupsionit dhe, në këtë mënyrë, për të ofruar informacion të zbatueshëm dhe të përshtatshëm për politikën që do të ndërmerren dhe masat përkatëse. Të dhënat për rastet e raportuara të korrupsionit vuajnë nga një "shifër e errët" shumë e lartë, d.m.th., përqindja e korrupsionit që nuk raportohet apo zbulohet nga institucionet e drejtësisë penale. Kjo ndodh sepse viktimat ose dëshmitarët e korrupsionit zakonisht kanë më pak gjasa të raportojnë raste të tilla sesa llojet e tjera të krimit. Prandaj, të dhënat për rastet e raportuara të korrupsionit duhet të interpretohen me kujdes, pasi ato mund të japin më shumë informacion mbi aktivitetin dhe reagimin e sistemit të drejtësisë penale ndaj korrupsionit, sesa për shtrirjen aktuale të fenomenit. Në fund të fundit, përdorimi i metodave të drejtpërdrejta mbi përvojën e korrupsionit është qasja më e besueshme për prodhimin e informacionit të detajuar mbi korrupsionin, i nevojshëm për qëllime të politikëbërjes (p.sh., identifikimi i zonave, procedurave ose pozicioneve në rrezik të prirur ndaj korrupsionit, ose monitorimi i tendencave me kalimin e kohës).

Anketat e mostrës garantojnë anonimitetin e përgjigjeve dhe ofrojnë një kontekst që i bën të anketuarit më të përshtatshëm për të zbuluar përvojat e tyre. Kur zbatohen siç duhet, anketat e korrupsionit mund të prodhojnë edhe vlerësime të "shifrës së errët" të korrupsionit. Anketat e mostrës mundësojnë krahasueshmërinë e të dhënave, gjë që është thelbësore për monitorimin e tendencave dhe vlerësimin e masave kundër korrupsionit. Ato gjithashtu mundësojnë mbulimin e grupeve të ndryshme të synuara (p.sh., individët, bizneset, familjet etj), gjë që është me rëndësi të madhe për të kuptuar se si llojet e korrupsionit dhe rreziqet ndryshojnë midis aktorëve të ndryshëm.

Teksa fokusi i kësaj metodologjie është te popullata e përgjithshme, mund të merren parasysh edhe grupe të tjera të synuara të të anketuarve, si : zyrtarët publikë, përdoruesit e shërbimeve publike dhe bizneset. Brenda popullatave të synuara, të dhënat e mbledhura përmes anketave të mostrës mundësojnë përshkrimin e fenomenit, dinamikën dhe mekanizmat e tij në lidhje me grupet e ndryshme të nënpopullatës me interes të veçantë, për shembull, grupet që janë veçanërisht të cënueshme ndaj korrupsionit ose në rrezik.

Anketat e mostrës mundësojnë mbledhjen e të dhënave në nivel mikro, duke ofruar analiza mbi incidencën e krimit dhe 'viktimat' e tij. Për më tepër, mbledhja dhe analiza e mikro-të dhënave, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, mund të stimulojë kërkime dhe analiza të mëtejshme të modeleve dhe tendencave të korrupsionit. Burimet më të njohura dhe më të përdorura, zakonisht përmbajnë pikë ose nota, vlera të kuantifikuara të caktuara për karakteristikat cilësore. Shumë prej tyre janë gjithashtu hibride – pjesërisht matje dhe pjesërisht vlerësim cilësor – të konvertuara në pikë.

Krahasimi mes burimeve të ndryshme të të dhënave shërben për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë situatën në lidhje me korrupsionin në vend dhe përhapjen e tij. Po ashtu, studime, analiza të mëparshme, raporte të certifikuara shërbejnë për efekt krahasimi në rastin e zhvillimit të pyetësorit të ri.

Fakti që ne nuk mund të matim drejtpërdrejt korrupsionin dhe asnjë mjet i vetëm nuk mund të japë panoramën e qartë, ndodh për disa arsye:

- Për shkak se korrupsioni përfshin shumë forma dhe praktika në sektorin publik por dhe privat, dhe asnjë mjet/instrument i vetëm nuk mund të shpjegojë shtrirjen e plotë të problemit.
- Megjithatë çdo mjet ofron informacion të kufizuar, nevojiten burime të shumta për të ndërtuar një pamje më të plotë të sfidave të korrupsionit dhe luftën ndaj tij.
- Statistikat, vlerësimet me pikë dhe indekset nuk mund të përshkruajnë faktorët nxitës qofshin ata ligjorë, institucionalë, socialë, ekonomikë dhe politikë të korrupsionit. Një informacion i tillë, megjithatë, është i nevojshëm për të interpretuar rëndësinë dhe implikimet e matjeve dhe për të parë e matur perceptimin publik në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim ndërmarrjen e hapave për përmirësim.

Për arsyet e cituara më sipër krahasimi i të dhënave të ndryshme, i shërben qëllimit për realizimin e objektivit të këtij instrumenti. Çdo lloj metode ka kufizimet e veta. Korrupsioni është, nga natyra e tij, një aktivitet i fshehtë që shpesh nuk është në interesin vetjak të pjesëmarrësve për ta raportuar. Kështu, vetë-raportimi mund të mos jetë i sinqertë, madje edhe në një format anonim, sepse personat e përfshirë mund të preferojnë të shmangin tërheqjen e vëmendjes dhe tërheqjen e kontrollit të fushave të tyre të aktivitetit korruptivë.

Niveli i korrupsionit që zbulohet nga gazetarët dhe institucionet e zbatimit të ligjit mund të mos ketë ndonjë lidhje të qëndrueshme me nivelin e korrupsionit ekzistues. Rastet e dokumentuara mund të përfaqësojnë majën e ajsbergut ose një përqindje të shumës totale, në varësi të sofistikimit të aktorëve të përfshirë dhe efektit të përpjekjeve monitoruese dhe zbatuese.

Për të realizuar një analizë krahasuese duhen mbajtur në konsideratë hapat si vijon:

-  ***Përcaktimi i Pyetjeve të Kërkimit***  
Përpara se të fillojë analiza krahasuese, është e rëndësishme të përcaktohen pyetjet e kërkimit që do të kërkojnë përgjigje. Pyetjet duhet të jenë të specifikuar dhe të përqendruara në aspektet që janë objekt i krahasimit.
-  ***Zgjedhja e Grupeve ose Konteksteve për Krahasim***  
Identifikimi i grupeve, individëve, periudhave kohore, ose konteksteve që do të krahasohen. Këto mund të jenë grupet e ndryshme të popullsisë, vendet, kulturat, etj.
-  ***Zgjedhja e Metodologjive të Përshtatshme***  
Për secilën pyetje të kërkimit, duhet të përzgjidhen metodologjitë e përshtatshme për të mbledhur dhe analizuar të dhënat. Këto mund të përfshijnë metoda kuantitative dhe kualitative, anketa, intervista, analiza e dokumenteve, etj.
-  ***Mbledhja e Të Dhënave:***  
Realizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave bazuar në metodologjinë e zgjedhur. Kjo përfshin identifikimin e burimeve të të dhënave dhe mbledhjen e informacionit nga grupet e krahasuara.
-  ***Analiza e Të Dhënave:***  
Përdorimi i metodave statistikore, analizave të vargjeve të të dhënave, interpretimeve kualitative, etj., për të vlerësuar ndryshimet dhe krahasimet midis grupeve ose konteksteve.
-  ***Të Dhëna dhe Interpretimi:***  
Paraqitja e rezultateve të analizës dhe interpretimi i tyre. Përshkrimi i ndryshimeve të konstatuara dhe përfundimet që dalin nga krahasimi.
-  ***Vlerësimi i Dallimeve dhe Kufizimeve:***  
Reflektimi mbi dallimet midis grupeve ose situatave, si dhe identifikimi i kufizimeve të analizës. Kjo fazë ndihmon në kuptimin e rezultateve dhe vlerësimin e besueshmërisë së tyre.

## 13. Korniza kohore dhe buxhetimi

Politika dhe vendimmarrja e bazuar në prova mbeten kritike për adresimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe pengesave që ato përfaqësojnë. Në këtë kontekst, përdorimi i mostrave të anketave të bazuara në metodologji të unifikuar dhe transparente që janë testuar dhe promovuar në nivel ndërkombëtar, mund të prodhojë tregues të rëndësishëm për shtrirjen dhe përhapjen e praktikave korruptive. Shkalla e përhapjes së korrupsionit gjithashtu mund të ndryshojë me kalimin e kohës.

Në të vërtetë, anketat e korrupsionit janë më të dobishme nëse përsëriten në intervale të rregullta, duke bërë kështu të mundur monitorimin e ndryshimeve në fusha të veçanta.

Korniza kohore për kryerjen e pyetësorëve/anketave (timeline) përfshin fillimisht identifikimin e fazave dhe detyrave të projektit ose aktivitetit. Kjo përfshin njohjen e hapave kryesorë dhe aktivitetëve që duhet të kryhen gjatë kohës së projektit. Pasi janë identifikuar fazat dhe detyrat, vlerësohet koha e nevojshme për kryerjen e tyre. Ky vlerësim mund të përfshijë kohën minimale dhe kohën maksimale të nevojshme për secilën detyrë.

Bazuar në vlerësimet e kohës, përcaktohen datat e fillimit dhe përfundimit të secilës detyrë dhe fazë. Ky proces ndihmon në krijimin e një kornize kohore të qartë me qëllim mundësimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve të mundshme. Buxhetimi i pyetësorit/anketës kalon nëpër disa faza:

- **Identifikimi i kostove:** Për secilën fazë dhe detyrë, identifikohen kostot e mundshme. Kjo përfshin shpenzimet për burimet njerëzore, materiale, teknologjike dhe të tjera që mund të dalin gjatë kryerjes së projektit.
- **Vlerësimi i shumës së nevojshme financiare:** Pasi janë identifikuar kostot, ato vlerësohen në një shumë totale. Ky është buxheti total që do të nevojitet për të kryer projektin.
- **Përcaktimi i burimeve financiare:** Pas vlerësimit të shumës totale, duhet të identifikohen burimet financiare që do të mbulojnë këto shpenzime. Kjo përfshin burimet nga buxheti i përgjithshëm i institucionit/organizatës, donacionet, financimet e huaja, ose burimet e tjera të disponueshme.
- **Menaxhimi i buxhetit:** Gjatë kryerjes së projektit, është e rëndësishme të monitorohen dhe menaxhohen shpenzimet në krahasim me buxhetin. Në rast të ndonjë ndryshimi në koston apo buxhetin, duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme.

Përdorimi i një kornize kohore dhe buxheti të qartë ndihmon në zbatimin dhe ndjekjen e projektit në një mënyrë efikase, duke lejuar përdoruesit të identifikojnë dhe adresojnë problemet potenciale në kohë dhe të mbajnë nën kontroll shpenzimet.

## 14. Raportimi dhe shpërndarja

Të dhënat që mblidhen dhe analizohen nga pyetësorët duhet të raportohen në strukturat përgjegjëse për të adresuar problemet respektive. Ato duhet të paraqiten jo vetëm në formën e raporteve narrative, por duhet të jenë të shoqëruar edhe me tregues statistikorë të paraqitur në formën e grafikëve, tabelave, etj.

Nisur nga interesi publik dhe e drejta e informimit, qytetarët dhe grupe të caktuara të interesit duhet të njihen me këto të dhëna në forma dhe mënyra të ndryshme të publikimit dhe publicitetit të tyre. Publiku mund të njihet përmes mediave konvencionale apo rrjeteve sociale.

Krijimi i kanaleve të komunikimit për dialog është me rëndësi në këtë drejtim. Qeveria krijon mundësi për të mbledhur propozime ose për t'u angazhuar në një dialog për të marrë ide nga shoqëria.

Qeverisë dhe qytetarëve u vijnë në ndihmë mjete të reja të teknologjisë dhe platforma digjitale për raportimin dhe denoncimin e korrupsionit.

Përmes këtyre teknologjive/platformave të teknologjisë ndërtohen mjete të reja analitike për t'i bërë të dhënat më të kuptueshme dhe më të aksesueshme për publikun. Në kuadër të parimit të open data (të dhëna të hapura) duhet të bëhen të aksesueshme në kohë dhe në një format të lexueshëm.

Të dhënat e mbledhura në kuadër të pyetësorëve/anketave duhet të përmbliidhen dhe analizohen me anë të një raporti. Faza e raportimit të të dhënave përfshin:

- **Përgatitjen e Raporteve:** Përfshin mbledhjen dhe organizimin e të dhënave për të krijuar një raport të strukturuar. Ky proces përfshin analizën e të dhënave dhe hartimin e një dokumenti të përgatitur për shpërndarje. Pas mbledhjes së pyetësorëve të plotësuar nga të anketuarit, hapi tjetër i rëndësishëm është të analizohen me kujdes të dhënat e mbledhura dhe të evidentohen gjetjet. Ky raport i analizës së pyetësorëve shërben për të analizuar të dhënat cilësore të mbledhura nga një numër i caktuar individësh e për të përmbledhur rezultatet e arritura (rezultatet/konkluzionet duhet të jenë rrjedhojë e analizës së bërë). Sipas nevojës, raportit mund t'i shtohen diagrama, grafi, tabela statistikore.
- **Struktura e Raportit:** Përcaktimi i strukturës së raportit duke përfshirë seksionet kryesore, si:
  - Hyrjen
  - Përcaktimi i qartë i qëllimit, objektivit të synuar, duke përcaktuar kur dhe si është mbledhur informacioni i analizuar në raport.
  - Evidentimin e metodave të përdorura për mbledhjen e të dhënave (është e rëndësishme të citohen metodat e përdorura, fokus grupi me të cilin është kryer pyetësori, numri i personave që i janë nënshtruar pyetësorit ose intervistës, mënyra ose formula e nxjerrjes së të dhënave)
  - Përmbajtja (përfshin informacion mbi të dhënat për secilin seksion dhe pyetje të pyetësorit të paraqitur në mënyrë narrative dhe/ose grafike)
  - Konkluzionet, rekomandimet, dhe të dhënat shtesë që mbështesin analizën (Konkluzionet nxirren nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve, ndërkohë që rekomandimet janë sugjerime mbi përmirësimin e politikave të antikorrupsionit bazuar në konkluzionet e nxjerra.



- **Përshtatshmëria e Audienca:** Përshtatja e gjuhës dhe stilit të raportit sipas audiencës së synuar.

Faza e fundit përfshin shpërndarjen dhe bërjen publike të raportit dhe të dhëna të mbledhura nga pyetësit. Gjatë kësaj faze duhen mbajtur në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- **Zgjedhjen e metodave të shpërndarjes:** Përfshin vendosjen e metodave për shpërndarjen e informacionit, si dërgimi i raporteve nëpërmjet email-it, publikimi online, printimi, etj.
- **Mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë:** Kur shpërndahet informacioni, është e rëndësishme të mbahen parasysh masat për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave, sidomos nëse informacioni është i ndjeshëm.
- **Ndarja me audienca të përcaktuar:** Shpërndarja e raporteve ose informacioneve me grupet apo individët e përcaktuar të interesuar. Kjo përfshin ndarjen e informacionit me të gjithë personat që kanë nevojë për të, pa shpërndarjen e tepërt.

Përdorimi i Teknologjisë dhe Platformat e Shpërndarjes:

- **Përdorimi i email-it dhe Sistemeve të Përbashkëta të Dokumentave:** Këto janë mjetet e zakonshme për të shpërndarë dokumente dhe informacion online. Email-i mund të përdoret për të shpërndarë raportet te institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile partnere.
- **Publikimi Online dhe Mediat Sociale:** Përdorimi i faqeve të internetit dhe platformave të mediave sociale për të ndarë informacionin me një audiencë më të gjerë.
- **Printimi dhe shpërndarja fizikisht:** Përdorimi i printimit të materialeve dhe shpërndarja fizikisht nëpërmjet postës, dërgimit të materialeve në dorë, etj.

## 15. Vlefshmëria dhe besueshmëria

Që të dhënat të jenë të besueshme duhet që anketat/pyetësit të jenë hartuar dhe dizenuar në mënyrën e duhur dhe termit të jenë përcaktuar me kujdes. Gjithashtu e rëndësishme është edhe kampioni i përzgjedhur dhe numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë dhe grupet ku është aplikuar pyetësi.

Pyetësit që lidhen me përvojën mund të jenë më të besueshme në gjurmimin e ndryshimeve, por ato gjithashtu kanë pjesën e tyre të subjektivitetit. Anketat e përvojës kryesisht targetojnë vetëm disa lloje specifike të korrupsionit dhe për këtë arsye mund të mos përfaqësojnë nivelin aktual të korrupsionit që ndodh në shoqëri.

Barrierat për angazhimin e qytetarëve mund të shfaqen në anën e qytetarëve, autoriteteve ose në komunikimin mes tyre.

Si të tilla mund të përmendim:

- Apatia e qytetarëve për të marrë pjesë është sfida e përhapur në shoqëritë e sotme bashkëkohore për shkak të mosangazhimeve qytetare dhe politike dhe ndaj eksperimentet e suksesshme të angazhimit qytetar janë të vështira për t'u mbështetur. Si rrjedhojë vlerësojmë se duhen identifikuar ato grupe të shoqërisë të cilët janë më të prekur nga fenomeni i korrupsionit dhe janë më të prirur të angazhohen dhe të kontribuojnë në raportimin e këtij fenomeni.
- Publiku heterogjen përfshin interesa, preferenca dhe aftësi të ndryshme ndaj kërkohet një analizë paraprake e audiencës së synuar të një nisme specifike, preferencave dhe aftësive të tyre dhe marrja në mënyrë proaktive e një spektri të gjerë opinionesh nëse është e nevojshme.
- Disproporcioni dhe pritshmëritë e pabaza në partneritetin ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve, duke përfshirë shpërndarjen e përgjegjësisë dhe asimetritë e pushtetit në bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve.
- Pabarazitë në përdorimin e teknologjive qytetare, sepse jo të gjithë janë të familjarizuar me teknologjitë e reja të komunikimit dhe jo të gjithë mund t'i përdorin dhe aksesojnë ato. Kjo varet p.sh. nga grup-mosha, aftësimi teknologjik, arsimi etj.

Publikimi i të dhënave që nxirren nga pyetësorët dhe çështjeve të evidentuara duhet të bëhet duke evidentuar qartë dhe me transparencë metodologjinë e ndjekur. Kjo do të rrisë edhe besueshmërinë e të dhënave dhe informacionit që buron nga ky instrument.



**Vlefshmëria** ka të bëjë me faktin se sa arrin një mjet, një metodë, ose një test të matë vërtetë atë që është pretenduar të matë. Nëse një mjet ose metodë është vlefshëm, atëherë ai përcakton atë që ai pretendon të përcaktojë. Për shembull nëse një test i konceptuar për të matur aftësitë matematikore të nxënësve është vlefshëm, atëherë rezultatet e tij duhet të korrespondojnë me aftësitë matematikore të vërteta të nxënësve.

Në disa raste, mund të ketë sfida në vlerësimin e vlefshmërisë për shkak të komplikimeve metodologjike ose vështirësive në matjen e çështjeve të caktuara.

**Besueshmëria** përcakton se sa konsistent është një mjet, një metodë, ose një test në kohë dhe në përdorues të ndryshëm. Nëse një mjet është i besueshëm, atëherë do të sjellë rezultate të ngjashme në situata të ndryshme dhe në përdorues të ndryshëm. Për shembull nëse një test i njëjti jep rezultate të ngjashme kur përdoret nga persona të ndryshëm në kohë të ndryshme, atëherë mund të konsiderohet i besueshëm. Problem mund të përbëjnë ndikimet e faktorëve të tjerë, si ndryshimet në ambjent, gjendje emocionale, apo ndryshime në kontekst, të cilat mund të kenë ndikim në besueshmëri.



## 16. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet janë me rëndësi në përfundim të një instrumenti të tillë dhe sintezë e trajtimit dhe analizës së bërë nga të dhënat e mbledhura.

Konkluzionet japin një panoramë të situatës së korrupsionit dhe perceptimit të qytetarëve në lidhje me këtë fenomen dhe përhapjen e tij. Nëse është e mundur konkluzionet duhet të evidentojnë edhe modelet pozitive apo praktikatat e mira.

Nga analiza e pyetësorëve nxirren problemet kryesore dhe evidentohen nevojat për ndërhyrje përmes mjeteve dhe mekanizmave të ndryshëm në lidhje me parandalimin e korrupsionit.

Konkluzionet duhet të jenë të qarta, koncize dhe të adresojnë problemet kryesore të evidentuara si dhe nevojat për ndërhyrje.

Këto pyetësorë shërbejnë për të prodhuar të dhëna më të vlefshme, të besueshme dhe të përditësuara, mbi korrupsionin, mbi matjen e nivelit të rrezikut të korrupsionit dhe të efektivitetit të politikave e strategjive kundër korrupsionit, në mënyrë të vazhdueshme. Një ndër konstatimet e përpjekjet e ndryshme për të matur korrupsionin është se matjet e korrupsionit përmes pyetësorëve të bazuar në përvojë ofrojnë informacion më të vlefshëm sesa mjetet e bazuara në perceptim. Ato ofrojnë prova sistematike dhe gjithëpërfshirëse të cilat ne mund t'i përdorim si bazë për hetime të mëtejshme ose qëllime të politikëbërjes dhe ndërtimin e strategjive të duhura.

Rekomandimet duhet të jenë konkrete dhe të adresojnë problemet e evidentuara nga të dhënat e mbledhura. Ato janë sintezë e analizës së të dhënave të mbledhura. Rekomandimet janë një komponent kritik i studimeve/raporteve që ofrojnë njohuri vepruese dhe propozojnë drejtime të ardhshme bazuar në gjetjet e evidentuara. Shkrimi i rekomandimeve efektive kërkon analizë të kujdesshme, qartësi dhe lidhje me objektivat dhe rezultatet e synuara.

Mbi bazën e rekomandimeve që dalin, adresohen problematikat përkatëse që lidhen me korrupsionin, si dhe evidentohen pikat se ku duhet ndërhyrë për efekt të politikëbërjes dhe strategjive të reja, apo ndryshimeve në ato ekzistuese.

Së fundi, duke pasur parasysh ndikimin negativ të korrupsionit, është gjithashtu e rëndësishme të mendohet se çfarë qëndron në skajin e kundërt të spektrit. Cilat synime pozitive lidhen në luftën kundër korrupsionit? Me rëndësi të veçantë janë nocionet e integritetit (përfshirë integritetin personal, politik, ekonomik dhe organizativ), drejtësinë dhe besimin e qytetarëve tek institucionet, fuqizimin dhe kënaqësinë e qytetarëve dhe, në fund të fundit, mirëqenien për qytetarët.

Gjithashtu theksojmë se pyetësorët mund të përmirësohen në varësi të shtrirjes, situatës, target-grupit si dhe prioriteteve të caktuara. Pilotimi është një mundësi e mirë për të bërë rishikimin e pyetësorëve në komponentë të caktuar.

Një faktor tjetër i rishikimit që bëhet nga ekspertët qëmerren me këtë instrument lidhet me problematikat e reja që shfaqen në praktikë, reforma të caktuara, apo prioritetet e vendosura, ndaj dhe modelet e pyetësorëve mund të pësojnë ndryshime kohë pas kohe në zëra të caktuar.



# Shtojca nr.1 Model pyetësori perceptimi

## *Titulli: Perceptimi publik mbi Korrupsionin*

**Hyrje:** Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë sondazh/pyetësor. Komentet tuaja janë të vlefshme për të kuptuar perceptimin publik mbi përpjekjet kundër korrupsionit. Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme sinqerisht dhe sipas njohurive tuaja. Përgjigjet tuaja do të përpunohen duke ruajtur konfidencialitetin dhe anonimat.

## **Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme**

**1.1. Moshë:** \_\_\_\_\_

**1.2. Gjinia:**

- Mashkull
- Femër

**1.3. Arsimi:**

- a) Arsim bazë;
- b) Arsim i mesëm, gjimnaz
- c) Diplomë e ciklit të parë "Bachelor"
- ç) Diplomë e ciklit të dytë "Master"
- d) Diplomë e ciklit të tretë të studimeve

**1.4. Punësimi:**

- a) Student
- b) I papunë
- c) I punësuar
- ç) I vetëpunësuar

**1.5. Të ardhurat:**

- a) 0 - 50 000 lekë
- b) 50 001 - 60 000
- c) 60 001 - 200 001
- ç) 200 001 - më tepër

**1.6. Burimi i të ardhurave:**

- a) Pagat dhe shpërblimet e tjera që lidhen me marrëdhëniet aktuale të punës;
- b) Vetëpunësimi
- c) Të ardhurat nga Biznesi;
- ç) Të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë;
- d) Të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
- e) Të ardhurat nga qiratë e pasurive të paluajtshme;
- f) Të ardhurat nga reminitancat;
- g) Të ardhurat nga pensionet;
- h) Të ardhura informale.

## **Seksioni 2: Perceptimi i përgjithshëm i korrupsionit**

**2.1.** Si do ta vlerësonit nivelin e përgjithshëm të korrupsionit në vendin tuaj në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "pa korrupsion" dhe 10 "jashtëzakonisht i korruptuar"?

- 1 [] 2 [] 3 [] 4 [] 5 [] 6 [] 7 [] 8 [] 9 [] 10

**2.2.** Sipas jush, si ka ndryshuar niveli i korrupsionit në vend në pesë vitet e fundit?

- a)** Është rritur
- b)** Është ulur
- c)** Mbeti i njëjtë
- ç)** Nuk e di

**2.3.** Përse mendoni ju se zyrtarët korruptohen? Ju lutemi përshkruani shkurt përgjigjen.

**2.4.** Sipas mendimit tuaj cili është sektori ku është më i përhapur korrupsioni:

- a)** Polici
- b)** Prokurori
- c)** Gjykata
- ç)** Shëndetësi
- d)** Arsim
- e)** Pushtet lokal
- f)** Tatime
- g)** Administratë qendrore (ministri)
- h)** iShërbime të tjera publike (specifiko) \_\_\_\_\_

## **Seksioni 3. Njohuritë mbi mekanizmat ekzistues për denoncimin e rasteve të korrupsionit**

**3.1.** A keni dijeni mbi procedurat që duhet të ndiqni për raportimin e rasteve të korrupsionit:

- a)** Po
- b)** Jo

**3.2.** A keni dijeni mbi institucionet ku mund të adresoni rastet e korrupsionit:

- a)** Po
- b)** Jo

**3.3.** A jeni në dijeni të masave, politikave dhe legjislacionit në fuqi kundër korrupsionit:

- a)** Po
- b)** Jo

## **Seksioni 4. Efektiviteti i masave kundër korrupsionit:**

**4.1.** A besoni se qeveria juaj po zbaton në mënyrë efektive politikat dhe masat kundër korrupsionit?

- a)** Po
- b)** Jo
- c)** Nuk e di

**4.2.** Si i vlerësoni efektivitetin e masave kundër korrupsionit në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "joefektive" dhe 10 "shumë efektive"?

- 1[]2[]3[]4[]5[]6[]7[]8[]9[]10

**4.3.** Si e vlerësoni punën e institucioneve ligjzbatuese kundër korrupsionit në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "joefektive" dhe 10 "shumë efektive"?

- 1[]2[]3[]4[]5[]6[]7[]8[]9[]10

**4.4.** Si e vlerësoni kuadrin ligjor dhe politik kundër korrupsionit në Shqipëri në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "joefektive" dhe 10 "shumë efektive"?

- 1[]2[]3[]4[]5[]6[]7[]8[]9[]10

**4.5.** Mes masave që duhen për të luftuar korrupsionin, cila prej tyre besoni se është më efektive: (mund të rrethoni më shumë se një)

- a) Rritja e pagave;
- b) Më pak dokumenta, procedura dhe burokraci;
- c) Punonjës më të kualifikuar dhe të trajnuar që u shërbejnë qytetarëve;
- ç) Rritja e kontrollit dhe mbikqyrjes ndaj zyrtarëve;
- d) Procedura funksionale raportimi dhe ankimimi;
- e) Ofrimi i më shumë shërbimeve online;
- f) Ashpërsimi i masave dhe sanksioneve ndaj akteve korruptive;
- g) Forcimi i sistemit të drejtësisë;
- h) Nëse keni të tjera, mund t'i specifikoni \_\_\_\_\_

## **Seksioni 5: Raportimi i korrupsionit**

**5.1.** Nëse do të jeni dëshmitarë të korrupsionit, a do të ishit të gatshëm ta raportonit atë tek autoritetet kompetente kundër korrupsionit?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta

**5.2.** Cilët faktorë do të ndikojnë në vendimin tuaj për të raportuar korrupsionin? (Rretho të gjitha ato që mendoni se vlejnë si faktorë)

- a) Mbrojtja e anonimitetit
- b) Besimi tek autoritetet për të ndërmarrë veprime konkrete
- c) Frika nga hakmarrja
- ç) Besimi se raportimi nuk do të bëjë ndryshim
- d) Të tjera (ju lutem specifikojini) \_\_\_\_\_

## **Seksioni 6: Komentet shtesë**

**6.1.** Ju lutemi ndani çdo koment ose sugjerim shtesë në lidhje me përpjekjet kundër korrupsionit dhe atë që ju sugjeroni.



## Shtojca nr.2. Model pyetësori përvoje

### *Titulli: Përvojat në lidhje me korrupsionin*

**Hyrje:** Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë sondazh/pyetësor. Komentet tuaja janë të vlefshme për të kuptuar perceptimin publik mbi përpjekjet kundër korrupsionit. Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme sinqerisht dhe sipas njohurive tuaja. Përgjigjet tuaja do të përpunohen duke ruajtur konfidencialitetin dhe anonimat.

### **Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme**

**1.1. Moshë:** \_\_\_\_\_

**1.2. Gjinia:**

- Mashkull
- Femër

**1.3. Arsimi:**

- a) Arsim bazë;
- b) Arsim i mesëm, gjimnaz
- c) Diplomë e ciklit të parë "Bachelor"
- ç) Diplomë e ciklit të dytë "Master"
- d) Diplomë e ciklit të tretë të studimeve

**1.4. Punësimi:**

- a) Student
- b) I papunë
- c) I punësuar
- ç) I vetëpunësuar

**1.5. Të ardhurat:**

- a) 0- 50 000 lekë
- b) 50 001 - 60 000
- c) 60 001 - 200 001
- ç) 200 001- më tepër

**1.6. Burimi i të ardhurave:**

- a) Pagat dhe shpërblimet e tjera që lidhen me marrëdhëniet aktuale të punës;
- b) Vetëpunësimi
- c) Të ardhurat nga Biznesi;
- ç) Të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë;
- d) Të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
- e) Të ardhurat nga qiratë e pasurive të paluajtshme;
- f) Të ardhurat nga reminitancat;
- g) Të ardhurat nga pensionet;
- h) Të ardhura informale.

## **Seksioni 2: Përvojat dhe vëzhgimet personale**

**2.1.** A keni hasur apo jeni prekur personalisht nga korrupsioni në çfarëdo forme gjatë vitit të kaluar? Ju lutemi përshkruani shkurt situatën (nëse është e aplikueshme).

**2.2.** Nëse jeni prekur personalisht nga korrupsioni, atëherë a keni qenë të detyruar të paguani apo të jepni favore për zyrtarët publikë që lidhen me sa vijon:

- a) Për të marrë shërbimet publike bazë;
- b) Për të marrë licenca ose leje;
- c) Për të mos paguar/përfitur nga detyrimet tatimore;
- ç) Për shërbime shëndetësore;
- d) Për të ndikuar në proceset gjyqësore;
- e) Për të përshpejtuar procedura administrative të tjera;
- f) Tjetër \_\_\_\_\_ (specifiko)

**2.3.** Koha kur është propozuar, dhënë, kërkuar ose marrë, përfitimi i parregullt:

- a) para marrjes së shërbimit
- b) pas marrjes së shërbimit,

**2.4.** Sa është vlera e përfitimit të parregullt të propozuar, dhënë, kërkuar ose marrë:

- a) deri në vlerën 50 000 lekë
- b) mbi vlerën 50 000 lekë

**2.5.** Sipas mendimit tuaj cili është sektori ku është më i përhapur korrupsioni:

- a) Polici
- b) Prokurori
- c) Gjykata
- ç) Shëndetësi
- d) Arsim
- e) Pushtet lokal
- f) Tatime
- g) Administratë qendrore (ministri)
- h) Shërbime të tjera publike (specifiko)

## **Seksioni 3: Raportimi i Korrupsionit**

**3.1.** Nëse keni qenë dëshmitarë të korrupsionit, a e keni raportuar atë tek autoritetet kompetente kundër korrupsionit?

- a) Po, e kam raportuar
- b) Jo, nuk e kam raportuar
- c) Nuk kam qenë dëshmitar i ndonjë rasti korruptivë.

**3.2.** Nëse përgjigja e mësipërme është a), a mund të na thoni se ku e keni raportuar:

- a) Polici
- b) Prokurori
- c) Institucionet kundër korrupsionit;

- ç) Portal Qeveritar
- d) Media
- e) OJF
- f) Tjetër \_\_\_\_\_ (specifiko)

**3.3.** Nëse përgjigja e pyetjes 4.1 është b), a mund të na thoni faktorët që kanë ndikuar në vendimin tuaj për të mos raportuar korrupsionin? (Rretho të gjitha ato që mendoni se vlejné si faktorë)

- a) Mbrojtja e anonimitetit
- b) Besimi tek autoritetet për të ndërmarrë veprime konkrete
- c) Frika nga hakmarrja
- ç) Besimi se raportimi nuk do të bëjë ndryshim
- d) Të tjera (ju lutem specifikojeni): \_\_\_\_\_

**3.4.** Në rastet e raportimit të korrupsionit si i vlerësoni nivelin e reagimit të organeve kompetente ndaj rastit të korrupsionit të denoncuar në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "i ulët" dhe 10 "i lartë"?

- 1[]2[]3[]4[]5[]6[]7[]8[]9[]10

**3.5.** Si e vlerësoni efektivitetin e masave dhe veprimeve të ndërmarra në kuadër të ndëshkueshmërisë së akteve korruptive të raportuara në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është "joefektive" dhe 10 "shumë efektive"?

- 1[]2[]3[]4[]5[]6[]7[]8[]9[]10

#### **Seksioni 4: Komentet shtesë**

**4.1.** Ju lutemi ndani çdo koment ose sugjerim shtesë në lidhje me përpjekjet kundër korrupsionit dhe atë që ju sugjeroni.

# Shtojca nr.3. Model pyetësori për bizneset

**Titulli:** *Pyetësor me biznesit në lidhje me perceptimin e bizneseve mbi korrupsionin*

**Hyrje:** Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë sondazh/pyetësor. Komentet tuaja janë të vlefshme për të kuptuar perceptimin publik mbi përpjekjet kundër korrupsionit. Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme sinqerisht dhe sipas njohurive tuaja. Përgjigjet tuaja do të përpunohen duke ruajtur konfidencialitetin dhe anonimat.

## **Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme**

### **1.1. Forma e organizimit tuaj është:**

- a) Person fizik
- b) Shoqëri kolektive
- c) Shoqëri komandite
- ç) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
- d) Shoqëri Aksionere.

### **1.2. Numri i punonjësve në kompaninë tuaj është:**

- a) 1-10 të punësuar
- b) 11-50 të punësuar
- c) 51-250 të punësuar
- ç) Më shumë se 250 të punësuar.

### **1.3. Sektori/fusha në të cilën kompania juaj operon është:**

- a) Transport
- b) Ndërtim dhe prona të paluajtshme
- c) Shërbimet financiare
- ç) Industria Tekstile
- d) Bujqësi
- e) Turizëm
- f) Teknologji e informacionit dhe komunikimit
- g) Prodhim
- h) Sektori Bankar
- i) Sektori i Sigurimeve
- j) Tjetër (specifiko).

## **Seksioni 2: Perceptimi i përgjithshëm i korrupsionit**

### **2.1. Si e perceptoni nivelin e korrupsionit në Shqipëri**

- a) Korrupsioni është një çështje shumë kritike në Shqipëri
- b) Korrupsioni është një çështje e rëndësishme, por jo në një nivel alarmues
- c) Korrupsioni nuk është një çështje shumë e rëndësishme në Shqipëri
- ç) Korrupsioni është pothuajse joekzistent në Shqipëri
- d) Nuk e di

**2.2.** Sipas jush, si ka ndryshuar niveli i korrupsionit në vend në pesë vitet e fundit?

- a)** Është rritur
- b)** Është ulur
- c)** Mbeti i njëjtë
- ç)** Nuk e di

**2.3.** Sipas mendimit tuaj cili është sektori ku është më i përhapur korrupsioni:

- a)** Polici
- b)** Prokurori
- c)** Gjykata
- ç)** Shëndetësi
- d)** Arsim
- e)** Pushtet lokal
- f)** Tatime
- g)** Administratë qendrore (ministri)
- h)** IShërbime të tjera publike (specifiko)

**2.4.** Çfarë mendoni se i shtyn bizneset të përfshihen në veprime korruptive?

- a)** Të përshpejtojnë një procedurë burokratike
- b)** T'i shmangen ndonjë penalteti
- c)** Të kenë qasje në një shërbim të veçantë
- ç)** Tjetër (specifiko)

**2.5.** A mendoni se është korrupsioni i pranishëm në veprimtaritë e prokurimit publik?

- a)** Shumë i pranishëm
- b)** I pranishëm
- c)** I pranishëm në shkallë të ulët
- ç)** Aspak i pranishëm
- d)** Nuk e di

**2.6.** Sipas jush, si ka ndryshuar niveli i korrupsionit në vend në pesë vitet e fundit?

- a)** Është rritur
- b)** Është ulur
- c)** Mbeti i njëjtë
- ç)** Nuk e di

**2.7.** A ka ndikuar korrupsioni në vendimet tuaja për të investuar në Shqipëri?

- a)** Po
- b)** Jo
- c)** Perceptimi mbi nivelin e korrupsionit ka rritur hezitimin tonë, por ne sidoqoftë kemi vijuar me investimet.

### **Seksioni 3. Efektiviteti i masave kundër korrupsionit:**

**3.1.** Si e vlerësoni efikasitetin e institucioneve përgjegjëse kundër korrupsionit?

- a)** Shumë efektive
- b)** Efektive
- c)** Jo shumë efektive

- ☒ c) Aspak Efektive
- ☐ d) Nuk e di

**3.2.** Si i vlerësoni efektivitetin e masave kundër korrupsionit?

- ☐ a) Shumë efektive
- ☐ b) Efektive
- ☐ c) Jo shumë efektive
- ☒ d) Aspak Efektive
- ☐ e) Nuk e di

**3.3.** Si e vlerësoni kuadrin ligjor dhe politik kundër korrupsionit në Shqipëri?

- ☐ a) Shumë efektive
- ☐ b) Efektive
- ☐ c) Jo shumë efektive
- ☒ d) Aspak Efektive
- ☐ e) Nuk e di

#### **Seksioni 4. Raportimi i korrupsionit.**

**4.1.** A jeni ballafaquar me korrupsion në sektorin publik?

- ☐ a) Po
- ☐ b) Jo
- ☐ c) Nuk kam qenë dëshmitar i ndonjë rasti korruptivë.
- ☒ d) Preferoj të mos shprehem.

**4.2.** Nëse jeni ballafaquar me korrupsionin a e keni raportuar atë tek autoritetet kompetente kundër korrupsionit?

- ☐ a) Po, e kam raportuar
- ☐ b) Jo, nuk e kam raportuar
- ☐ c) Nuk kam qenë dëshmitar i ndonjë rasti korruptivë.

#### **Seksioni 5: Komentet shtesë**

Ju lutemi ndani çdo koment ose sugjerim shtesë në lidhje me përpjekjet kundër korrupsionit dhe atë që ju sugjeroni.